YRTUE PREJ KOMISJONIT TEKNIK
Nr. 7.

ZEF SKIROI

MINO
ELEGJI

Gli albanesi sono eroi che si sono distinti in tutte le linee.
GARIBALDI

Dr. ZIAUDIN KODRA
N/DREJTOR I SHKOLLËS NORMALE

Si mbas vendimit të Komisjonit Teknik,
pëlqyem prej Ministris s' Arsimit me Nr. 940/II d. 16. XI. 1938.

ELBASAN, 1939.
Shtypshkronja "SAIDE,—Elbasan

BKSH

BKSH

BKSH

MINO SKIROI

që "... nga një kjint e sa do më mizorë,
Me zëmbër të thatë ashtu si hekur,
Te gjithë anët rrethuan, i forti djalë
Nuk luajti vendit, nuk e tha një fjalë;
E ndënji me guzim, si ata të motit
Trima Shkjypëtarë nga të cilët leu „;

e që "... seppe... conservare intatto l'onore
degli illustri avi albanesí... „.

BKSH

A. Giuseppe Schiró

Të nder1 kush isht i mirë edhe kujton
se, ç' i vogël, ti veje tue kërkuar
sa na mbeti nga t' parët, e s' harron
këngët e vjetra, çë, për tyj, sheh shkruar.2
Të nder përse, pa u lodhur, ti punon
për shkronjësyrën 3 t' ënë t' sbukuruar,
e cila sot prej teje thuaj se rron
me t' ëmbëlë një gluhë e të kjëruarë.

Do të shtonen për ditë e nam e nderë,
pas pemës çë me punën ti ke dhënë,
për të ngjallur të ri 4 t' atdheut të mjerë.

Kur te jeta të jen mé pakë t' lënë, 5
a në 6 dija e ndritoft gjinden ndo herë,
do t'thet kush të bë 7 lik: T'mos kisha klënë!

Trifonio Guidera da Piana. Canti Tradizionali, faqe 531.

---

1. Të nder=të ndëron; i miri të nderon
2. për ty=prej teje.
3. për shkronjësyrën=për letërsinë
4. për të ngjallur të ri=për ringjalljen
5. të lenë=të metë, të krisun nga mendja
6. a në=ase në qoftë se
7. kush të bë=kush të bani keq

BKSH

ZEF SKIROI

MINO
ELEGJI

Gli albanesi sono eroi che si sono distinti in tutte le linne.
GARIBALDI

Dr. ZIAUDIN KODRA
N/DREJTOR I SHKOLLËS NORMALE

Si mbas Komisjonit Teknik
Pëlqyem prej Ministrís s' Arsimit me
Nr. 940/II. d. 16. XI. 1938.

Shtypshkronja "SAIDE„—Elbasan

BISH

BKSH

PARATHANËJE

Jeta dhe veprat e poetit

Tingëllimi që kemi sjellë në faqen e parë tregon, në mënyrë të qartë punën e gjallë e të hapët që zhvilloi poeti, qysh në të ri, në lamën e gjuhës e të letërsisë shqipe, dhe n'ate të ringjalljes t' atdheut të largët.

Në qoftë se Skiroit, si thotë poeti në tingëllimin, nuk i u-njoftën meritat, pse atëhere errësina e padijes e mbulonte njerëzimin, e medje atëherë i banë edhe keq poetit, sot, ne me Shqipninë e lirë, t' i caktojmë Skiroit të Math vendin që meriton në mes të Shqiptarëve të Mëdhej: atij i përket një vend në mes burrave që u-përpoqën për lirimin e atdheut, e nji vend tjetër i përket në mes të poetëve të mëdhej të zanës shqip-iare. Vepra e Skiroit, si ajo e De Radës, âsht e dyfishtë: vepër letrare, me qëllim hartistik, dhe vepër politike, me qëllim pro-pagande për të bamë të njoftun çashtjen shqiptare në botën e huej që interesohej atëhere për vendin t' onë. Këtë qëllim pro-pagande të çashtjes shqiptare poeti e kryen tue i botue veprat e tij politike në gjuhën italishte, e ato letraret në shqipet, por me përkthimin italisht pranë.

Asht nji e vërtetë historike se Shqiptarët jashta Shqipnisë punuen ma tepër për Shqipni se Shqiptarët e mbrendshm, e ma tepër se të gjithë punuen t' Arbresht; ndër këta i pari âsht De Rada, dhe mbas tij vjen Skiroi.

Leu në Pjana dei Greci, katund afër Palermo-s, në Siqeli, me 10 Gusht 1865. Si don të thotë poeti, në "Te Dheu i Huaj„ e në "Mino-n„, familja e tij zbriste prej atyne familjeve të para që ikën prej Turkut dhe erdhën e zunë vend nëpër krahina të ndryshme të Italisë.

Shënji i shpis nuk ka në kot
dy drangonjë m' krahë kjyteze,
as pa arsye një hyll i plot,
n' arë t' kukje t' tij heth rreze! (Mino, IV. v, 657-660).

O Mino, o rrjedhë luftarësh mbretëra,
të rreptish trima shtërnip i ndritëshëm, . . . (ibid. VII. v. 853).

Mësoi në kolegjin italo-shqiptar të Palermo-s; ky kolegj, bashkë me atë të Shin Mitrit të Koronës qenë dy fënerë që lëshuen dritë kulture në Italin e jugut; prej këtyne dy instituteve duelën njerës të ndezun me flakën e lirisë kundra sundimit të randë të Borbonëve.

Poeti i ardhshëm ishte ende në shkollë të mesme kur filloi të merret me çështjen e gjuhës e të letërsisë shqipe. Nji e kusherina e Skiroit i shkruen nji letër De Radës, të cilit ja paraqet djaloshin si të zotin e pendës; këtë gja e provoi De Rada, kur filloi të pranojë në revistën "Fjamuri Arbrit„ shkrimet e poetit të ri.

Mbas botimit të disa hartimeve të vogla në ligjëratë të matun, si Skanderbeg e Kroja, aktiviteti i vërtetë i poetit në fushën letrare fillon më 1887, atëhere kur, ende 22 vjeç, boton Rapsoditë shqiptare, e po në këtë vjet, për të shkërbye veprën që zhvillonte De Rada me "Fjamuri-n (e) Arbrit„ i u përvesh edhe ai botimit të nji të përkoshmeje, me nji titull për t' u-vumë re : "Arbëri i Ri„, nga e cila për fat të keq nuk duelën veçse tre numra; por numri e sasija nuk i shton vleftën nji pune, e ata tre numra të asaj revistë bashkë me rapsoditë e banë të njoftun poetin e ri nëpër njerzit që interesoheshin aso kohe për çdo lëvizje intelektuale t' onën.

Më 1890 mbaroi mësimet në drejtësi; por, me gjith që umuer me studime të drejtësisë, tue botue edhe nji vepër origjinale "Hymje në studimin e të drejtës kriminale, sikurse u ka ngjamë disa poetëve të mëdhej, që kanë mësue ligjë e janë marrë me letërsi, si Petrarca, Tasso, Skiroi hoqidorë nga kjo degë dhe u-dha kryekëput mbas letrave të bukura; e në këtë u shtŷ ndoshta, prej dëshirës që kishte "të zbukuronjë shkronjësyrën t' onë„.

Vjetët e para të punës së tij i kaloi tue u-marrë me folklorën e kolonive t' ona në Siqeli, tue i botue ato që mblihte; në

këtë punoi me folkloristin e math italjan, Giuseppe Pitré. Në vjetin 1900 filloi të botojë vetë nji "Arkif shqiptar„ me kangët popullore fetare e morale, me rrëfime, gojdhana e prralla shqiptare etj; në këtë arkif botoi për herë të parë idilin e bukur "Mili e Hajdhia„, të cilin, si do ta shofim, do ta botojë edhe herë të tjera; më 1894 "Kangët popullore të mbledhuna në Shkodër„; më 1897 "Kënkat e Luftës„; më 1900 botimin e parë të veprës "Te Dheu i Huaj„ në nji vëllim me botimin e dytë të "Mili e Hajdhia„.

Shoqënitë e ndryshme t' Arbreshve të formueme në Kalabri e në Siqeli me kërkesat e tyne pranë qeverisë italiane mundën t' ja mrrijnë qëllimit për hapjen e nji kursi të gjuhës shqipe në Institutin e gjuhëve orientale të Napolit; të gjithë antarët e shoqnisë së Lungro-s, prej kah ishte nisë kërkesa pranë qeverisë italiane për themelimin e kësaj kathedre, pritshin me siguri, mbas pranimit të kësaj kërkese prej Qeverisë, e mbas vendimit të të XII tit Kongres të Orientalistëve, që këtë kathedër ta zinte De Rada; por me nji vendim që nuk gëlltitet lehtë e pa të bamë të mejtojsh pak për të gjetë arsyen, si profesor i gjuhës shqipe n' atë institut u-emnue Skiroi "në vend të De Radës që nga pleqënija e tij e nga shëndeti i dobët nuk do të kishte mujtë ta kryente atë punë me kujdesin e duhun e me qëndrimin e fortë në punë„. (shif La Nazione Albanese„, vjeti i V, 15 XII 1900). Këtë barrë poeti e mbajti për 27 vjet d. m. th. deri në ditën kur vdiq.

Mbas datës 1900 poeti, përveç detyrës si profesor, nuk la me nj' anë punën që kishte fillue mbi folklorën shqiptare; kështu më 1907 botoi "Kangët e shejta të kolonive shqiptare në Siqeli„; po në këtë vjet nxori në dritë botimin e IIItë të "Mili e Hajdhia„ e këtë herë me parathanëjen e Luigj Gurakuqit.

Përmendëm vjetin 1907 kur Austria me popujt e Ballkanit po përpiqesh të ndante lëkurën e harushës së ngordhun të Lindjes, e këtë ndamje mejtojshin ta bajnë edhe në shpinë të Shqipnisë; Skiroit në këtë kohë i u-desh t' interesohej e të luftojë

anmiqt që po i kërcënoheshin atdheut të tij të largët, e këtë luftë e bani me pendën e tij tue shkruejtë artikuj të ndryshëm; në këtë punë u-ndihmue edhe prej qeverisë italiane, e cila e dërgoi edhe në Shqipni me misione të ndryshme, më 1912-1914.

Më 1918 poeti botoi në Napoli veprën "Mbi gjuhën e letërsinë shqipe, në marëdhanëje edhe me kolonitë shqiptare t' Italisë„; kjo vepër që u-botue me rasën e përvjetorit të Institutit oriental të Napolit, ka randësi të madhe historike, pse, mbas asaj të Straco-it, âsht i dyti traktat i letërsisë s' onë. Vepra ka ma tepër randësi propagande: Jemi në vjetin 1918; âsht e vërtetë se Konferenca e Londrës e kishte njoftë Shqipninë, por ajo nuk na siguronte ende kurrgjâ; e këtë frigë e ka edhe poeti; ne na e kishin dhanë një herë emnin "Kitabsyz„= të pa libra, në Konferencën e Berlinit; poeti në këtë vepër flet përpara orientalistëve, përpara përfaqsuesve të kombeve të ndryshëm në atë Institut; ai don t' u tregojë atyneve e gjithë botës mbarë se nuk jemi "të pa libra„ si na kishin quejtë gjuhët e liga.

Kjo vepër âsht shkruejtë Italisht dhe "Instituto Per l' Europa Orientale„ i Romës, tue çmue randësin' e saj, e botoi përsëri më 1932.

Më 1923 poeti nxori në dritë "Canti Tradizionali ed altri saggi delle colonie Albanesi di Sicilia„; këto janë shumë kangë popullore që poeti i kishte botue ma parë e që tashti i boton përsëri të shtueme e të përmirësueme.

Prej kësaj date poetit i mbeten edhe katër vjet jetë; në këtë kohë merret me artikuj të ndryshëm e me vepra që na kanë mbetë të pa-botueme si "Te Dheu i huaj„ e "Kthimi„.

Mbas gjithë kësaj pune të pa pushim, jo i lodhun, por i "ndrydhun prej fatit„, poeti vdiq më 17 Fruer 1927 në Napoli. La mbrapa familjen dhe të vëllan Dr. Gjin Skironë, i cili po përpiqet që vepra e pa botueme e të vëllait të math të dali në shesh.

Veprat e poetit që meritojnë të përmenden mâ gjatë e gjanë janë këto:

Mili e Hajdhija, të cilën e botoi tri herë; botimi i parë âsht i vjetit 1890, n' arkivin shqiptar; i dyti u botue më 1900, më nji vëllim me "T'e Dheu i huaj„; dhe i treti e i fundit më 1907.

Idili Mili e Hajdhia âsht nji kryevepër e lirikes s'onë dashunore, âsht nji vepër, së cilës nuk mund t' i rrijë krahas asnji tjetër e letërsisë s' onë. Prej saj kuptojmë se gjuha shqipe ka qenë e zonja, qysh në mbarim të shekullit XIX, të shfaqi ide, mejtime e figura të nalta e të fuqishme âshtu si i ka ky idil; âsht nji gur i paçmueshëm i letërsisë s' onë që meriton të botohet si tekst për shkollat e mesme t' ona. Asht e vërtetë se gjuha âsht e pasun por nuk âsht aq e pastër sa âsht p. sh. ajo e Mino-s; duhet pohue se Skiroi shkonte tue i pastrue veprat e tij në pikëpamje të gjuhës; për të provue këtë le të marrim dy botimet e fundit të Mili e Hajdhisë; në atë të 1907 do të gjejmë shumë pastrime greqizmash; e po të krahasojmë botimin e fundit të Mili e Hajdhisë me Mino-n ndryshimi e pastrimi i gjuhës do të duket shumë i math; prej botimit të dytë të Mili e Hajdhisë deri ke ai i Mino-s kanë kalue plot 23 vjet, në të cilët poeti ka mujtë të mbledhi, edhe nga Shqipnia, fjalë që nuk ka mujtë t' i dinte. Asht për t'u verejtë se në gjuhën e Skiroit gjinden shumë, shumë ma rrallë barbarizmat italiane se ato greket.

Vepra e dytë, që ka ma tepër nji vleftë politike e patriotike e Skiroit e që meriton të zgjatemi pak mbi të, âsht ajo me titullin: "Kënkat e Luftës„, botue më 1897 në Palermo. Asht koha në të cilën brezat e rij të shqiptarëve duhet të ndizen për luftë me kangën e poetëve; e poeti Skiro i përvishet kësaj pune për të veprue âshtu si vepruen shumë poetë italianë në kohën e rilindjes s' Italisë, e në tonin e "La Marscillaise-ës „ shkruen gjashtë hymne lirie enthuziastike.

Këto i kopjova dikur me mund të math, mjerisht nuk m'u kthyen mâ prej atij, të cilit ja dhashë për t'i kopjue, veç më bije ndër mend se poeti ja kishte kuhtue De Radës e seseicili

prej tyne kishte në krye nga nji motto, ose nga ndonji varg të përmendun poetësh të mëdhej; më vijnë ndër mend vargjet e "La Marsciellaisë-s„:

Allons enfants de la patrie
Le jour de gloire nous apelle.

e ata të famshmit të Manzoni t:

Siam fratelli, siam strelti ad un patto,
maledetto colui che l' infrange!

Mbas tekstit të hymneve vijnë, më duket, 148 faqe me shënime e verejtje rreth çeshtjes së Lindjes. Poeti flet me dokumenta se populli shqiptar meriton të jetojë i l i r ë; thërret e bërtet për këtë l i r i; u turret ma tepër grekëve të cilëve u përmend se në lëvizjen e tyne të parë Shqiptarët qenë të parët ata që i këthyen pushkën Turqisë; qenë Shqiptarët e Ali Pashës ata që shkrepën të parën herë pushkën kundra Turqisë. Njeni prej këtyne hymneve, më duket i pari, " Flamuri i Shqipëris „ asht botue dy herë në nanduer e në dhetuer të vjetit 1935 te " Illyria „, nji herë prej Dr. Gjin Skiroit, dhe nji herë prej meje.

Këtu do të flasim edhe përmbi poemën epike të poetit, " Te Dheu i Huaj „, por do të flasim për ate në X kangë, që u-botue, si përmenda ma nalt, më 1900 në nji vëllim me Mili e Hajdhinë. Thom se do të flasim për atë të 1900, pse kjo poemë e zgjanueme. që flet edhe mbi ngjarjet e reja historike të vendit t'onë, ndodhet e pabotueme, në dorë të të vëllait të poetit; shpresohet që të botohet së afërmi.

Prej kësaj poeme të pabotueme kam pamë të botueme vetëm nji pjesë: " Ndërtimi i Kështjellës së Rojzafatit „, botue më 1914, në nji „ foglio volante ", në Durrës; e ka Z. Kolea, e ka botue edhe Z. Çabej.

Botimi i parë me veprën e zgjanueme ka shumë ndryshime.

T' i hedhim nji sy veprës së 1900:

Si thashë, poema ka X kangë; i âëht kushtue Anselmo

Lorecchio-s, që ka qenë atëhere drejtor i gazetës-rivistë „ La Nazione Albanese ". Si në Mili e Hajdhia, para poemës kemi nji elegji madhështore të letërsisë s' onë përmbledhun prej 10 strofash 4 vargjesh njimbëdhitë rrokës, por i katërti i çdo strofe âsht pesërrokës, i cili tue ndryshue masën për çdo strofë ja shton ma tepër copës karakterin elegjak dhe largon monotoninë e strofës 11 rrokse. Edhe këtë poemë e kam të kopjueme me dorë, e më pëlqën ta sjell këtu të gjithë këtë hymje për t' u-përmendë si pjesa ma e bukur e elegjive të shkrimtarëve t'onë në mërgim:

Ferrekje 1 të meruam, jo më skifterë
Të varfër na pa fan 2 te dheu liti, 3
Të dishirojëm nat e dit nga herë
O Shkjipëri.

.....

Ndë mes disave pa përzitë na jemi
Të huaj te vendi tu ku besa u rua;
Përpara sivet malet t' at po kemi
Fushat e tua.

.....

Përse po rrini ju, t' afërmit thonë,
Mbë klishë tue qerdhur lot e bët rëkë ?
Helmi i pasosëm isht e gjella jonë
S' ka më haré.

.....

E pa njohur, njeriu nuk' i duket kekj
Kjo rënkë çë po na vetëm ndëlkojëm; 4
Me zëmbër të këputur djelm e plekj
Mbi ne vajtojëm.

.....

O Kroja shejt, e bukura Janinë
O Shkodër, o katunde të lëvduam
Te reshtur 5 akjë mot nga dheuthi jinë
Gazin harruam.

Nga Turku atje të çkelur me gjërinë
Nën botës 6 çë me gjak të kukj bënë
Gjumë të rëndë çë të zgjuar nkë dinë
Gjishërat flënë.

.....

Të ndarë ndër ta, nka i huaji të munduar
Te shpit e tire më të zot ngë janë
Akjë mbi gjith njeri të dishiruam
Vllezrit t' anë.

.....

Të lum tri herë ata me të vërtetë
Çë dhunën e Shkjiptarëve ngë panë,
Po tue luftuar si trimavet i ngjet 8
Te varri ranë!

.....

Ngë panë të çprishur 9 për në jetës 10 farën
Çë e pa mundur 11 u duk Turkut një ditë;
Ngë panë të sprasme atë çë bën të parën 12
Naní pa dritë.

.....

Andaj të ngratit na po rrimë gjith monë
Mbë klishë tue derdhur lot e bem rëkë;
Helmi i pasosëm isht e gjela jonë
S' ka më haré.

1. Ferrak—ferrekje=zog ferre, zog trumcak.
2. pa fan=pa fat.
3. te dheu liti=në tokën latine, italjane.
4. Kurrkuj, pa e provue vetë, nuk i duket e randë kjo brengë që vetëm ne po ndiejmë.
5. Të reshtur=të larguem.
6. Nën botës=nën baltë, nën tokë.
7. aq të dishruem, të dashtun ma tepër se të gjithë.
8. i ngjet=u ka hije.
9. të çprishur=të shpërndamë.
10. për në jetës=nëpër botë.
11. e pa mundur=e pa thyeshme, „invineible".
12. veprat e tyne të nalta nuk i panë të bien poshtë.

Kjo vepër, me historin' e Skënderbeut e me Lautën e Malcis formon repertorin e epikës shqiptare. Në të ndeshim episode që na bajnë të mejtojmë Enenë, i cili me Ankizin në krahë e me perenditë e shtëpisë niset prej Troje për të gjetë tokën e premtueme; ajo shtërgata që ngrihet e përmbys barkat e Shqiptarvet që udhëtojnë prej Siqilije në Kampani na sjell ndër mend zemrimin e Junonës kundra Trojanëve; Shqiptarët që vuajnë nepër detë tue kërkue nji tokë shpëtimi për të ruejtë besën e nderin e tyne, na sjellin ndër mend Trojanët e Virgjilit që me perënditë e shtëpijve kërkojnë vend shpëtimi. "Te Dheu i Huaj„ âsht Odhisea dhe Eneida e letërsisë shqipe.

Të dy poemat, Mili e Hajdhia e Te Dheu i Huaj përveç vlefjave që përmendëm kanë edhe këtë: Janë dy vepra realistike, dy vepra që përshkruejnë jetën e gjallë të t' Arbreshve: besimin e math të tyne ke zoti, dashunin e madhe që kanë ende ata për atdheun e largët (shif hymjen e Te Dh. i H.), kultin e familjes shqiptare (Shif kangën e parë e Te Dh. i H.), nderimín dhe bindjen që tregojnë fëmijt përpara prindëve (Shif Mili e H. në kangën ku burrë e grue bisedojnë mbi martesën e të birit); e ma tepër se gjith çka Mili e Hajdhija e Te Dh. i H. na përshkruejnë në nji mënyrë plastike atë karakterin e Shqiptarit që nuk mund të përzihet, me atë të njerzëve të nji race e gjuhe tjetër.

Në vjetin 1923 poeti botoi veprën e tij madhshtore "I Canti Tradizionali..„ me nji hymje prej 137 faqesh, hymje e cila âsht nji histori e dokumentueme mbi nandë katundet të kolonive Arbëreshe në Siqeli. Veprën poeti ja kushton kujtimit të të birit, të Minos; ky kushtim përfshtiell ide e fjalë të nalta që për fat të keq janë n' italishtet; kësaj hymjeje historike mbi katundet t' arbëresh poeti i jep fuud me disa shënime mbi patriotizmën e mbi randësin e kolonive shqiptare në Siqeli e me nji ligjëratë të mbajtun prej poetit vetë në Pjana dei Greci në prani të N. M. V. Eman. III. Mbas këtyne shënimeve fillojnë vjershat të ndame në pjesë të ndryshme e të shënueme me nga nji numër rromak.

I. Canti Tradicionali: janë kangë që edhe të tjerë i kanë botue disa prej tyne, poeti na sjell nga nji herë edhe variantet e disave si p. sh. na jep tre varijante të kangës së Kostandinit të Vogël, t' asaj që âsht mâ e gjata e mâ e bukura.

II Canti didascalici, elegie e proverbi: janë dhetë hartime nga të cilat disa me të vërtet shumë të bukurra që meritojnë të botohen si tekst shkolle për klasët e ulta të shkollave të mesme; kanë karakter moral, patriotik njerzuer, dashunuer, fetar e tjera.

III. Canti Sacri: disa prej këtyneve i pat botue poeti me këngët e shenjëta që pat botue një herë në nji vëllim më vehte.

IV. Poesie inedite o rare di vari autori e qualche canto popolare.

V. Novelline popolari: janë dhetë pralla shumë të bukura në të cilat të tërhek sa gjuha, aq mënyra e bukur e të rrëfyemit; disa prej tyne meritojnë të botohen si tekste për shkollat t'ona.

VI. Kjo pjesë q' âsht edhe ma e bukura, e mbyll vëllimin e math prej 532 faqesh; vëllimi mbyllet me poemën origjinale të poetit, me Mino-n; Mino âsht emni përkëdhelës i Giacomo, të birit të poetit; poema në fjalë âsht nji vepër rase; në këtë poeti qan e vajton, në vargje madhështore, vdekjen e të birit, djal i ri. Jemi në vjetin 1920 kur Italija ishte e turbullueme prej ideve komuniste. Njt natë, 23 Korrik 1920, vjen në Pjana dei Greci, më duket, nji deputet i atij rrethi. Shfaqen disa manifestime antikombëtare; Mino-ja, i veshun me uniformën e Beksaljerit ndodhet n' atë rreth; ndëgjon zana që thrresin: "abbaso il militarismo, Abbasso la carne venduta„. Si kam ndigjue, Minushi paska qenë nji djalosh gjak-nxehtë me nji karakter enthuziast, ka qenë nji shqipo si gjith të tjerët né që nuk durojmë pluhën në vesh; para atyne fjalëve fyese i biri i poetit ve dorën në bajonetë e u turret kundërshtarvet, të cilët "nga e shuma të fortë„ e venë për posh, i ngulin disa thika dhe e shtien mbrenda në nji zyrë bujqësore aty afër rrugës "Në dhomën ku të vdiste

i dhanaruam„; n' at çast e çojnë në spital ku vdes po atë natë. Fashizmi i dha çmimin e arit.

Kjo vdekje tragjike i dha rasë poetit të shkruejë kryeveprën e tij, pse Minoja âsht, për mue, jo vetëm kryevepra e poetit, jo vetëm kryevepra e letërsis s' onë, por ajo âsht edhe nji kryevepër që mund të hahet me ato të letërsive ma të përparu-eme të botës; në të poeti ka dhanë prova të zotësisë së tij po-etike e të zotnimit të plotë të gjuhës shqipe; veprën e ndan në pjesë të ndryshme tue e përshkruejtë secilën prej tyne në nji masë të veçantë të poezisë. Tash 6 vjetë isha në nji bibliotekë kur këndova për të parën herë vargjet e fuqishëm të kësaj poeme; aty u-ndodha afër njij miku që kishte leçitë veprën e që kishte njoftë personalisht edhe poetin. Si hymje në fjalëve të mira që më drejtoi mbi veprën miku më tha: "Poetit i ngarkojmë shumë faje, shum gabime, kur po bahesh Shqipnija; por, shtoi miku, edhe si kur të jenë të vërteta ata faje e ata gabime un ja kam falë të gjitha vetëm pse Mino-n e ka shkruejtë në shqipet, vetëm pse, me vajët e tij, i fali letërsisë s' onë nji kryevepër të mbaruemë„. Mbasi e mbarova së këndueni veprën i dhashë të drejtë mikut dhe qysh atëhere e gjykova veprën shumë të bukur si tekst për shkollat të mesme t' onat. N' ate nxanësi shqiptar do të kuptojë se sa e zonja âsht gjuha Shqipe, aty do të mësojë shumë fjalë e mënyra të thanuni krejt shqip e që né ndoshta nuk i kemi sot. N'ate nxanësi Shqiptar do të këndojë të shkrueme në poezi. dhe në nji poezi të naltë e të fuqishme vdekjen e tipit trim shqiptar, t' atyne Shqiptarve që luftuen n' Egjipt me Mehmet Ali Pashën, në Greqi me Ali Pash Tepelenën dhe n' Itali me Krispin. Vepra âsht elegjake, por për ne Shqiptarët âsht nji pjesë e epikës s' onë; âsht epopeja e atyne kreshnikve arbnorë që, të mundun nga Turku, u-shpërndanë nepër të katër anët e botës, ndihmuen të shtypunit e shtypën shtypësit.

Malësorët Shqiptarë i erdhën në ndihmë poetit për t'i thurrë "lëvdinë„ Minushit; djeloshat Shqiptarë le t' i mësojnë përmenç ata vargje e t' i bajnë të kumbojnë me zanin e tyne malet e

Shqipnisë së lirë :

O burra o shok të parë të Kastriotit
Koha shpëresat t' uaja nuk i theu !

.....

Kurdoherë t' parët t' anë
Kush me mënt e kush me dorë,
Për atëdhe, ndër hije sa kanë
Klenë mbronjësë e dëshmorë . . .

BKSH

I

Këngën të çilni tesh, o Malisorë,
Kjesten e zëshme mjeshtërisht tue prekur,
të këmbojën lëvdije e bjeshkë e prorë,
lëvdis të birit t' im për të mos vdekur;
se nga një kjint e sa do më mizorë,
me zëmbër të thatë ashtu si hekur,
te gjithë anët rrethuar, i forti djalë
nuk luajti vëndit, nuk e tha një fjalë;
e ndënji me guzim, si ata të motit
trima Shkjyptarë, nga të cilët leu;
vërrejti armikjët, si Shkjyponja e Zotit,
e gjith' era shëndriti e shkrepi dheu.
O burra, o shokë t' parë t' Kastriotit,
koha shpresat t' uaja nuk i theu.

Kjo pjesë e parë e këtij poemthi përmblidhet prej 60 strofash tetëshe, 480 vargjesh 11 rrokës; në këtë, poeti përshkruen episodet mâ të dhimbëshme, prandaj përdor këtë masë të metrikës që âsht ajo mâ e fuqishmja; âsht edhe pjesa mâ e gjatë e poemthit, e 11 rroksi âsht ai që të mërzit e që të loth mâ pak se çdo masë tjetër.

v. 1-5. Poeti fton malësorët, ata që janë trima si Minushi, të thurrin, me kangët e tyne, lavdinë e të birit, ashtu si kishin zakon të këndojnë "Aedët„ e kohës heroike të Greqisë së vjetër dhe "Troubadoure-ët„ e Kohës së Mesme.

të çilni=me çelë; me ndezë; t' ja nisni, t' ja thoni.

tesh=tash.

kjesten=fjalë e vjetër, çeste-ja; nji soj kithare;

prorë=nuk duhet ngatrrue me omonimin, ndajfolje kohe, që domethanë **për orë**, gjithnjë; këtu âsht emën i rëndomtë në kuptimin e fjalës luginë; këtë fjalë e përdor poeti shpesh në kuptimin e sipërm p. sh. "Lil i vetëm te një prorë . . . Mili e Haj, VIII. v. 16.

v. 5-10. **se . . . nuk luajti vëndit**=mund të merret si fjali shkajkore ose si fjali objektore e fjalisë së parë "këngën të çilni„.

te gjithë anët rrethuar=në të gjitha, nga të gjitha anët i rrethuem . . . . . qëndroi si burrat e nuk tha fjalë që të tregojshin friksimin e tij.

Pa t' veni re nani edhe pran të thoni
në një si Minon pat shkjipúa shkjipóni.
T' atheut për hie se deshi t' ish ushtar,
ata ç' u blen nga i huaji syt i ngulën
e tinas u betuan për të m' e vrar.
Mbi një vetull e vun disa kësulën
(burra për lojë e trima për të sharë)
e nga e shuma të fortë, atij i u sulën . . .
Po duallë ai prej tufës fakjebardhë,
si dielli del nga ret pa pasur mardhë.

v. 10-15. Qysh këtu poeti i thurr të birit lëvdatën e madhe, tue e quejtë atë si nji stërnip t' atyne Shqiptarëve trima të vjetër; në këtë pikë vepra del shumë e bukur e me nji interes të math patriotik për ne Shqiptarët. Mbas mendes s' ime heroizma e Minushit âsht sintheza e epopesë të të gjithë atyne trimave arbënorë që punuen e që dhanë jetën për vendet e hueja; mjafton të përmendim Sulltanët e shumtë që raca e jonë i ka dhanë Turqisë: Mehmet Ali Pashën e Egjiptit, Krispin e të tjerë djelmosha arbëresh që mbetën dëshmorë në radhët e para të "Këmishave të Kuqe„ të Garibaldit; italjani i math, në nji letër që i shkruen Dora D' Istra-s, përmbëleth, në fjalë lakonike, trimninë e ushtarëve të tij arbresh: "Gli albanesi sono eroi che si sono distinti in tutte le linée„. Nji shembëll heroizmi arbresh âsht edhe vepra guximtare e Agesilao Milano-s, arbresh nga Benedeto Ullano, i cili deshi të vrasi Ferdinandin e Napolit pse s' e mbajti fjalën që i kishte dhanë popullit për nji qeveri të lirë; për këtë gja flet historiani De Cesare "Regno di Napoli„.

era=ajri, hapsina.

shkrepi=lëshoi shkëndi, shkreptimën.

O burra . . .=Me gjithqë ka kalue nji kohë e gjatë prej ditës që kur Shqipnia u shtrue nga Turqit, prap se prap shpresat t' ueja o Shqiptarë, nuk kanë humbë.

v. 15-20. Nji provë se shpresat e Shqiptarëve nuk kanë humbë âsht heroizma e Minushit. Shikoni tashti, thotë poeti, edhe pastaj të thoni në qoftë se ka pasë shqiponja ndonji herë nji zog si Minushin.

nani=tashti.

pran=pastaj.

Tri herë për kushtrim era gjëmboi.
— Jik, Mino, (i tha ndonjë) se gjakun duanë —
— Për Zotin e vërtet, nuk jik Skjiroi
Shpëtim me turp të parë nuk kërkuan.
Do t' vdes, në hera e fatit më kjilloi;
po kënga, çë te moti namin ruan,

---

shkjipúa=âsht kallzore, zogu i shqipes.

shkjipóni=âsht emnore, shqiponja.

Pse desh t' ishte ushtar për nder t' atdheut ata që e shitën vehten ke i hueji (ke komunistët) ja vunë synë e u-betuen që ta vrasin fshehtazi.

M'e vrar=ajo më-ja âsht plotës ethik që tregon nji kohësisht dashunin e babait për të birin e dëshpërimin e tij për humbjen e djaloshit; në Shqipet nji plotës të tillë e gjejmë mâ dendun në poezinë popullore. Shkrimtarët arbresh, sidomos De Rada e Variboba e përdorin shumë:

Se **m' u** rresht njera çë ra.
Tek e bardha shpia ime. (Milosao-Kangjel i parë).

Zgjou, bir, jo ma gjumë
Zgjou se m' i fjajte shumë.
Jeta im, xha m'u zgjo (Gjella e Sh. M. Virgjër).
Zgjou se bare nino.

i huaji=emën kolektiv, të huajtë.

v. 20-25. Këtu poeti përshkruen atë tip të poshtër e frikacak që trimnohet përpara kundërshtarit, i cili fizikisht e materialisht âsht mâ i dobët; në kundërshtim me poshtërsinë e këtij tipi âsht trimnija e Minushit që n' atë çast shkëlqeu si rrezja e Diellit; pse ishin shumë, ishin edhe të fortë.

Ju sulën=i u vërsulën, i u ndenë.

Tufës=Poeti e përkthen me fjalën Italisht mischia=përleshje.

mardhë=âsht emën që s' ka të bâjë me kuptimin të ftofët; këtu ka kuptimin e fjalës njollë.

v. 25-30. Minushi âsht stërnipi i atyne trimave të vjetër Shqiptarë që fituen namë, por që e fituen pa frigë e pa u-turpënue; e djaloshi trim don të veprojë n' atë mënyrë. Janë të bukura gjithë ato copa të kësaj pjese të poemthit të cilat përsërisin idenë që Minushi, Shqiptar jashta Shqipnisë, përpiqet të tregohet trim ashtu si kanë qenë edhe stërgjyshnit e tij.

Era=shif ma nalt vargun 12.

Gjëmoi=ushtoi, buçiti.

Në hera=në qoftë se çasti, ora.

do t' thet se vran në Pjanë bersaljerin,
se deshi vëndin e lirin e nderin.
Se vëndin deshi akjë sa s' mundet më,
të gjithë i ran të poshtërit mbi kokë;
po kur për Mbret u fal kuj i dha zë
e çë m' e la të lidhur e pa shokë.
Dragua çëdo këlysh aiherna u bë,
sa më një herë u ngukj e thata tokë;
se më i pashpirt i Pjanës ë një bulk,
se një i tmeroshëm e gjakpirës, ulk.

---

v. 30-35. Do të vdesë, por kanga do të përjetsojë trimnin' e tij.

Te moti=gjat kohës, shekujve.

Do t' thet=do të thotë.

Në Pjanë=Në Pjana dei Greci, Katund Arbëresh në Siqeli, afër Palermos.

Bersaljerin=Në ushtrin Italiane "bersaljeri„ âsht ushtari i trupave të zgjedhuna të fanterisë; pse âsht i zgjedhun e pse ruhet për ekspedita të vështira ka nji emën të math. Natën e kobshme të vrasjes, Minushi ishte i veshun me uniformën e bersaljerit.

të poshtërit=janë komunistët.

v. 35-40 **ahierna**=atëhere.

u ngukj=u skuq.

ë një bulk=âsht nji bujk (një bujk i Pjanës âsht mâ i tmershëm e mâ gjak-pirës se nji ujk).

v. 40-45. poeti përsërit barbarizmën e bashk-fshatarve që treguen kur vran të birin; këtu kemi nji krahasim: si duhija që rrëzon përdhé thëneglat prej degës së nji molle, kështu edhe "Kjenëria„ (socialistët) u-hoth e bâni plojë mbi trupin e Minos.

Shtu=Heth poshtë me forcë, folja: shtie, shtinja, shtura, shturë, a shtënë.

plojë=rrëmujë, përleshje, fjalë që nuk e kanë t' Arbëresht por që poeti, si ban shumë herë, e ka marrë prej gegënishtes së sipërme. Kujtoj se âsht koha të themi që Sqiroi e ka pasunue fjalorin e gjuhës së fshatit të vet me fjalë të marruna nga viset e ndryshme të Shqipnis e me neologjizma të ndërtueme prej tij.

Thënegulla të zeza mbi një mollë,
çë shtu nga dega e 'saj në dhè duhia,
Mbi kurmin t' ënt të bukur e të hollë
u hoth e bëri plojë kjenëria . . .
çë m' hokje, o djali i jim, n' atë të ndollë,
për të cilën ka dhunë njerëzia
Se e tillë e zezë më s' u vërtetua
Kjysh kur të birin klajti e Fjeshta Grua.
Sa hokje, o biri i jim, po te një mbrëma,
s' trashëgove në tër jetën t' ënde.
Ndër 'ta, çë patën nepërka për ëma.
si kjëngji midis ulkjëvet u gjënde.
E t' kekjes s' tyre ka me u ndiejtur gjëma;
ngjera çë liset nuk do t' njihen krënde
ngjera çë ka zëmbra t' mira n' botë

---

v. 45-50. **Çë m' hokje**=sa vuejte.

të ndollë=përdorim i ll-së në vend të dh-së; sikurse ngjan në të folmet e Gjinokastrës e të Shkodrës.

Dhunë=turp; kemi edhe foljen me dhunue = me turpënue, me çnderue.

e zezë=kob, e keqe.

Klajti=qau; grupet kl, gl ruhen edhe sot ndër Arbresht, sikurse ruhen mirë edhe në Çamëri.

e Fjeshta grua=gruaja e pastër, it. "L' Immacolata„.

v. 50-55. Atë që hoqe vetëm në nji natë nuk e gëzove gjithë jetën, o bir; si qingji në mes të ujqëve u-ndodhe, e u-ndodhe në mes t' atyne që patën nepërka për nana.

po te një=ajo po-ja asht vu për të forcue kuptimin, ri në vend të fjalës **vetëm** në nji natë (Minushi u-vra natën ka ora 24).

S' trashëgove=nuk gëzove; në këtë kuptim e përdor poeti edhe në "Mili e Hajdhia„. Te ku u shkjuajta edhe trashëgova.

s' do t' thahen mbi varr t' ënt e lule e lotë.
Te dhoma, ku, të vdiste i dhanaruam;
të vetëm fakjezezët e këlkjosën;
ndë luce gjaku, nga një mijë t' çuam
varra çë për mëndér i fortëlosën
e misht e njomë i bën të shënjtëruam;
të trimit syt e brëndëshmë u shkëlkjosën
e pan atë çë nuk u dha me u par
një shpirti ç' edhé s' ë nga kurmi i ndar.
— Në dorë, o Zot, të lë të drejtën t' ime,

v. 55-60. Gjama e veprës së tyne të keqe do të ndihet deri në ato ditë kur lisat do të quhen lisa e jo krande, deri n' atë ditë kur do të ketë zemra të mira në botë, lulet e lotët nuk do të thahen mbi vorrin tand o bir. Faqezijt të mbyllën të vetëm në dhomë ku të vdisnje i dëshpruem, e aty n' atë pellg gjaku të gjetëm me njimij plagë që të kishin coptue sa me të shti mnerën.

ngjera=deri sa.

dhanaruam=i dëshpëruem (nuk dihet rranja e fjalës e vendi ku përdoret).

këlkjosën=e mbyllën (ndoshta ka të baj me fjalën **kluç** të **sllavishtes**=kyçi, këndej kemi na sot fjalën me kyçë).

lucë=llucë gjaku, gjak të ngrim, "sang coigulé„.

mëndér=mnerrë, fjalë e ré për poetin.

çuan=gjetën. De Rada:

Vetum e **çoi** ndë vatërët
Çë këshenë më pieksënej

Variboba:

Pekurarët erthtin e djaljin e **çuan**
E ninën bashkë Zepën i kënduan.

fortëlosën=e banë fërtela fërtela, e coptuen.

v. 60-65. Mishi i njomë u-shejtënue, syt e djaloshit shkëlqyen e panë atë gjâ që nuk ka pamë kurr nji shpirt që s' âsht ende këputë nga trupi, d. m. th. se atë që panë syt e Minushit nuk e ka pa tjetër kush për së gjalli.

u shkëlkjosën=shkëlqyenë, me shkëlqye.

s' ë=s' âsht.

shpagim për faje e për çëdo detyrë.
Këta të hekjur e këta mundime
të dheut më lafshin çëdo xerk e t' ndyrë;
sa shpirtin, për sa ti do t' bësh kërkime,
të thjellët të m' e gjesh si një paskjyrë,
si grumbull ari çë prej zjarmit del,
a çë më shumë ndrit, sa do ç' u shkel.
O Zot, tue derdhun gjakun t' im për dhé.
s' e renj në, lule çë s' u çel, u vdes;
jetën i fal atij, si bëra bé . . .
Po nuk do t' shuhet më flaka çë ndes;
Të lutem pran, i mirë si ti je,
për tatën e për mëmën kij kujdes;
Shtoja fukjin edhe, e se i hirit krua,
kij përdëllim, o i madhi yn Zot, për mua ! . .

---

v. 65-70. Në dorë t' ande o Zot, e la të drejtën t' ime, për të pague fajet e detyrimet; këto vuejtjet e kësaj bote të mjaftojnë për të lamë ç' do njollë. Sa për shpirtin, sa do kërkime që të bajsh, do të ma gjejsh të pastër si nji pasqyrë.

detyrë=detyrim.

xerk=cirkë, pikë njollë.

të m'e gjesh=do të ma gjejsh.

v. 70-75. Do të ma gjejsh të pastër si nji grumbull ari që del nga zjarri, ose që ndritçon ma tepër, sa ma tepër të shkilet, të rihet, të shtypet; nuk ankohem pse po vdes i ri, si nji lule që s' ka çelë ende, pse po vdes për atdhe.

dhé=atdhe.

s'e renj nae=nuk ankohem në qoftë se; folja asht rienj; poeti thotë në "Mili e Hajdhia„: harroi folenë e fulakjinë ngë rien.

v. 75-80. I fal jetën atdheut ashtu si jam betue; por ideali i im nuk do të shuhet kurrë; prandaj të lutem, o Zot, të keshë kujdes prindët e t'ua shtojsh fuqinë, e si burim i hirit, kij mëshirë edhe për mue.

Pran=konsekutive, rrjedhore, prandaj.

Shtoja=Poeti përdor i-në, trajtën e shkurtën të përemnit vetuer njëjës, në vend të shumësit që asht u-ja; në "Te dheu i huaj„ Poeti thotë: "Po tue luftuar si trimavet i ngjet„. Ky përdorim i i-së në vend të u-së shifet edhe sot ndër ne gabimisht. Sa herë më ka ra rasa të verej nëpër hartime fraza si kjo: i tha trimavet, në vend që: u tha trimavet; në vend të shtoja duhet shtojua.

Përdëllim=Mëshirë.

Tha edhe xarë u ngreh me zi në truall,
te ku flamurin pa, çë luzma shkjori
me të trushkjyeshme duar' e vu nën shuall.
Tuke u dridhur për nder e mall, e mori
edhe në klinde t' tij gjith u pështuall,
i jaft i rrënjës çë në dritë e nxori;
e ashtu, t' atij në të lëvdoshme hie,
si dielli u duk në perëndim kur bie.
— O flamur, nga të gjithë i lavdëruam,
për të cilin te luftat ran disa
trima nani, si edhe te moti i shkuam,
tue marrë armikut një të vjetër uha,
u jam, se vdes për tyj, gjith i gëzuam,
e gas se i jimi më të math nuk ka;
përse, sa do çë t' bëja edhe të roja,

v. 80-85. Tha edhe rrëshqanas me zi u-ngrit në tokë, ku pa flamurin që turrma grisi me duer të mallkueme që vu nën kambë; tue u-dridhun për nderimin e për dashunin' e tij, mori flámurin e u-mbështuell në kindet e tij.

Xarrë=xvarrë, rrëshqanas, rrshan.

Te ku=atje ku.

Luzma=Grumbulli, turma në kuptim të keq.

Trushkjyeshme=Të mallkueme; ndërto: luzma shkjori flamurin e e vu nën shuall me duar të trushkjyeshme.

Mall=dashurija.

v. 85-90. I denjë i fisit që e nxori në dritë, u-duk si dielli kur perëndon në hije të lavdueme të flamurit.

v. 90-95. O flámur, për të cillin mbetën në luftë disa trima tashti edhe në kohën e shkueme, tue i marrë anmikut nji gjak të vjetër, unë pse po vdes për ty, jam krejt i gëzuem e gëzim ma të math se i emi nuk ka kurrkund.

Gaz=Gëzim, kënaqësi.

s' munt t' isha i zot më mirë të të nderoja.
O flamur trish të ngjyeme, ku i shëndetit,
në fushë t' kukje, shënji i math shkëkjen;
o flamur shëjt, çë në njësi t' vetvetit.
më t' lartat ndienja të njeriut ngërthen,
se i mleth të gjitha ato të të vërtetit
te Zoti besimtar, ç' atdheun shërben;
për dhunë e për të fyeme çë t' u bën,
gjith gjakun të kushtoj çë zembra nxën.
Mirë unë e di se s' derdhet kot ky gjak
ndonse zëmbrën e prindëvet m' e djek;
po para se më i madhi t' thuhet plak,
do t' duket se Klyshedhra e kukje u mek
e se i ngordhëjes s' saj u bëra shkak,
me ata çë, te ku do e mallkuara ndjek,

v. 95-100. ... sepse sado punë të mëdha të banja, sado të jetonja, nuk mund të të nderonja ma mirë se kështu, o flamur tri ngjyrash, në sipërfaqen e kuqe të të cillit shkëlqen shenja e madhe e shpëtimit, o flamur i shenjtë, që në tanësinë t' ande mbërthen ndjenjat ma të nalta të njeriut.

Trish të ngjyeme=tri ngjyrash.
I shëndetit=i shpëtimit.
Shenji i math=asht stema e flamurit italjan.
Ngërthen=mbërthen, përmbleth.

v. 100-105. ... sepse të gjitha cilësit e mira të njeriut të mirë e besimtar ke Zoti ti i mbleth në vetvehte, t' atij njeriu që shërben atdheun. Për turpin e për të fyemen që t' u bânë po të kushtoj gjith gjakun që nxen zemra e ime.

Dhunë=shif ma nalt v. 45-50.

Nxën=me zanë, me nxemun (Dibër), me marrë, "contenir„.

v. 105-110. Unë e di fort mirë se ky gjak nuk derdhet kot, megjithqë ma djek zêmrën e prindvet; por para se ma i madhi, ma i rrituni do të mplaket do të duket vdekja e kuçedrës së kuqe d. m. th. se nuk do të kalojë shumë kohë e do të duket që asht shue komunizmi, e shkaktar i kësaj vdekjes së kuçedrës jam unë, thotë Minushi.

M' e=e-ja asht pleonazëm e kundrinës së drejtë zëmbërën që sot në gjuhën t' onë bashkë me ë-në asht bamë a: të-|-e=ta më-|-e=ma.

tuke ndërritur se në dhé të plirë
do t' prishet për gjithmonë fara e mirë.
Dashurije një zjarr u çel për vënt
këtu, ku ndienjat më të larta u shuan;
këtu, ku s' kanë edhe më t' mirët mënt
e t' vjedhur t' jerët e të vrar po duan;
këtu, ku t' shëntëruam nuk ka më sënt
e vese njerëzije edhe u haruan;
këtu, ku shahet nat' e dit' atdheu , . .
këtu, ku armiku më të shumët bleu . . .

Klyshedhra e kukje=personifikim i komunizmit në nji kulshedër të kuqe që po msyn botën.

Ngordhëjes=tregon përbuzjen që ka poeti për këtë doktrinë shkatërruese të shoqnisë njerëzore; me ngordhë përdoret për kafshët e në Dibër vetëm për disa; për delen e për pulën, për të cilat tregon nji dashuni populli nuk thotë ngordhi por cofi; për derrin thotë me plot gojën: ngordhi derri! Mbaj mend se kur isha fëmij shumë herë më kishin thanë që asht "keç„, **gjynah** të thuesh: ngordhi delja.

v. 110-115. Unë u bana shkak i ngordhjes së saj bashkë me ata që gjithandej mundon kulshedra e mallkueme tue andërrue se në dhé të përgjakun do të prishet për gjithmonë raca e mirë. Unë po ndez nji zjarr për vend, këtu ku janë shue ndjenjat ma të nalta të njeriut.

Me ata çe=bashkë me ata të cillët.

Te ku do=në çdo vend.

E mallkuara=kulshedra e mallkueme.

Ndërritur=andërrue.

Ndjek=mundon "persécuter„.

Plirë=përlyem, përgjakun.

Çel=ndes; edhe sot përdoret në jugë, p. sh. çele zjarrin.

v. 115-120 ... këtu edhe ma të mirët s' kanë mend e të tjerët duen veç të vjedhin e të vrasin, këtu ku s' ka ma gja të shejtë e janë harrue zakonet e mira, këtu ku shahet atdheu e ku ma të shumtën anmiku i ka blemë.

t' vjedhur e të vrar=emna të gjinisë asnjanëse.

po=asht vu për të forcue kuptimin, zen vendin e fjalës **vetëm.**

Vese=këtu zakonet e mira; por fjala ves-i ka gjithnji kuptim të keq, sikurse âsht edhe në latinishtet vitium, nga e cila vjen fjala e jonë.

Kalonte koha e i bënëshin të rënda
mlezat e syvet; këmbëzit i u smardhën
e t' eshtrave ne palca i hyri brënda,
të ftohtit edhe buzësit i u sbardhën;
e pamundëshme e zu si e gjumit ënda,
ndonse kish etë e ndiej te fyti hardhën;
Pran psherëtijti: — O mëma e jime!... O ta...
Po fjalën nuk e sosi e fryma e la.
E kje se behas ndër të plirat rrakje
të dhomës, çë bë shëjtë dëshmimtari,
shkrepi një rreze e mbi të hieshmen fakje
t' atij, çë rinte po si lil te bari,
derdhi harén e të pasosmes pakje,
si dielli silën mbi lëvdi Shkjiptari,
si vesën hënza mbi vullajë n' verë:

v. 120-125. Koha po kalonte e po i randoheshin kapakët e syve; kambët i ngrinë e të ftoftit i hyni mbrenda në palcë të eshtnave, e iu sbardhën buzët.

mlezat=mbulesat, kapakët e syve.

smardhën=i ngrinë; kemi edhe foljen me mardhë, me mërdhifë.

v. 125-130. E kapi nji andje gjumi që ay nuk mund ta shtypte, ndonse kishte etje e ndiente në fyt nji djegëje; pastaj psherëtiti: o nanë.... o ta... (të), por nuk e mbaroi fjalën e fryma e la.

e pamundëshme=që ai nuk mund t'a mundëte, t'a shtypte, "invincible„, "indomptable„.

hardhën=të ndezun, të djegun.

v. 130-135. E ja se befas, ndër plaçkat e përgjakuna, të dhomës që u-ba e shejtë prej atij dëshmori, e mbi faqen e hieshme t' atij që rrinte si zambaku në bar, shkëlqeu nji rreze e lëshoi gëzimin e paqës së përhershme, ashtu si dielli e lëshon shkëlqimin e vet mbi lavdin e Shqiptarit, ashtu si hanza e lëshon vesën mbi votrat e kopshtit në verë, sa për nji çast, e bukur u-duk edhe vdekja.

të plirat rakje=plaçka të përgjakuna; raqe, raçe, plaçka.

çë bë=që u-bâ.

silë=nga sllavishtja silla=forcë, fuqi; këtu: **shkëlqim i diellit.**

vullajë=votrat e kopshtit a të yrtit.

sa e bukur edhe mortia u duk një herë.
Te nata e nëmurë e të Premtjes mjet,
ç' e korrikut e katërta, në vit
një mijë e nëndë kjint edhe një zet,
kjilloi, për zi të Pjanës, ç' u korit,
sa hie s'ka më me pasur e shëndet,
i madhi Bir i jim në kjell u ngjit
e zuri vënt ndër 'ta çë s' do t' harrohen,
ngjera çë trimat për mbi dhe t' nderohen.
O Mino, o biri i jim, kush t' i mbëllijti
syzit e tu, kur nusia e 'tyre u fik,
si hyll çë posa të sbardhurit e prijti,
tretet kadalë e në të kaltërt ik?
e lotëzën e sprasme kush t' e fshijti? . . .
I vetëm ishe, pa gjëri pa mik;

---

v. 137-145. Mu në natën e kobëshme, të mallkueme të të Premtes, katër Korrik, 1920, ngjau, për zi të Pjanës, që u-turpnue sa s' ka mâ bukuri e shpëtim, që i Madhi im bir, u-ngjit në qiell e zu vend atfër atyneve që nuk do të harrohen deri atëherë kur do të nderohen trimat përmbi dhe.

mjet=mu, shi.
m' u-korit=m' u turpnue.
hie=bukuri, në kuptim të zgjanuem ndei; it. "decoro„.
shëndet=shpëtim.

v. 145-150. O Mino, kush t' i mbylli syt kur u-mek bebja e tyne, si nji yll që, po sa priti të sbardhunit e dritës shduket ngadalë e ikën në të kaltërt? e lotin e fundit kush ta mshiu?

mbëllijti=mbylli.
nusia=bebja e synit.
të sbardhurit=të sbardhunit e dritës, agimi.
tretet=m' u-tret, m' u-humb, m' u-shduk.

pa mëmën t' ënde edhe pa mua përanë . . .
Po Zotin pate edhe të parët t' anë !
Ata t' u mblodhën; se ndomos si mbete
me buzë m' gas, ashtu si vet të pash,
si n' ëndërrë t' meroshme ? Te ku e gjete
të butën kjetësi, kur u të rash
përpara m' glunjë e tue mos klënë n' vete.
Ndërsa jot' ëmë, pa ulurima grash,
pa besë t' ruante me ata sy të sbjerrë,
si korë e dhëmbësis në gur e nxjerrë ?
Si t' pash, o bir . . . Im bir ësht ky ? . . . Minushi
çë me kujdes edhe me mall u rrita ? . . .
Ai çë zëmbrën me gëzim m' e mbushi,
n' atë kur zura t' njihesha për dita ? . . .
Im bir ësht ky ? . . . Nuk i ka bijtur pushi

---

v. 150–155 Ishe vetëm, pa fis, pa miq, pa nanën e pa babanë . . . por pate Zotin edhe të parët t' onë; t' u ndodhën ata pranë, pse për ndryshe si qindrove me buzë në gaz, ashtu si të pash unë, unë që isha si në nji andërr të tmershme ? Ku e gjete atë qetësi të butë kur të rashë përpara në gjunjë ? kurse nana, pa ulurima, si e kanë zakon gratë, pa besuem, të vërente me sytë e saj të humbun, ajo që ishte bâmë si dhimsunija vet' e skalisun mbi gur ?.

se ndomos=pse për ndryshe.
te ku=ku ?.
Pa besë=pa besuem.
Ruante=shikonte, vërente; në këtë kuptim e përdorin edhe të tjerë shkrimtarë Arbëresh p. sh. Variboba diku thotë: "Ruaj rigalë çë ti sualltin„.
të sbjerrë=të humbun.
Korë=fytyrë; fjalë që vjen nga greqishtja **ikona** tue u-kthye n-ja në r.
Dhëmbësis=dhimsunis.

v. 161-169. Në ç' gjendje të pashë, o bir, . . . kur fillova të njof vehten time në te, në Minushin . . . ende nuk i ka dal qimja, leshi në fytyrë
mall=dashuri.
n' ate=në Minushin.
pushi=lesht e fytyrës.
kjiti=nxori.

edhe në mjekërrë e më del nga drita
e diellit t' ënë, po si vet s' kujtoja . . .
Si trim mbi trimat çë na kjiti Kroja;
I ri një djalë kur kjillon se vdes,
për atë ç'ish njëmënt e kla gjëria,
dhe më për 'të ç' e priste t' ish dënes,
e thot se nuk smadhon nga dashuria
se duket dita e mirë çë në mëngjes.
Po shpresat, çë ti ndeze, o bir, te shpia,
s' i prishi, por i vu në rrugë mora . . .
Jo një kështu me tyj, dy vetë û sbora !
Sbora një djalë çë më të mirë s' kishte
në çëdo vënt e në çëdo krahinë,
për shpirt të math e të sjella t' bujarishte,
si edhe për hie të lules s' re në stinë;

v. 169-175. Kur qëllon që vdes nji djal i ri fare fisi e qan me të vërtet për atë që ishte djali dhe fare-fisi dënés për atë që priste të bahesh djali, fare-fisi thotë se nuk ja kalon kufinit në të dashun të djalit, pse duket dita e mirë qysh në mëngjes, d. m. th. se e ka njoftë djalin që në të ri, se do të bahesh i mirë. Por shpresat që ndeze, ti, o bir, në shtëpi nuk i shujti, por i vu në rrugë vdekja.

për 'të=për atë, për cillsit e tij.
dhe më=edhe ma tepër.
nuk smadhon=nuk ja kalon masës, nuk e rrit kot dashuninë për djaloshin.
morë=mortja, vdekja.

v. 176-184. Me vdekjen tande un humba dy vetë : humba nji djalë qi s' kishte mâ të mirë . . . për shpirtin e tij të math e për sjelljet e tij bujare, si edhe për bukurin' e nji lules së re në stinën e vet; humba nji trim, i cilli me gjith qi ishte i vogël, aq ma i math u-duk në radhën e trimave, në çastin kur njeriu i math e tregon vehten, në çastin kur shpirti nduket, këputet nga trupi.

t' sjella bujarishte=sjellje bujare, fisnike.
hie=bukuri.
Sbora=me sbjerrë, me humbë.
në krinë=në radhë.
herë=çasti, ora.
nduket=me ndukë, me shkulë, me këputë.

sbora një trim çë, ndonse i vogël ishte,
të trimavet akjë më i math në krinë
u duk te hera kur i madhi duket . . . . .
te hera çë prej kurmit shpirti nduket.
E si të sbora, o bir . . . Më patshë uratën,
çë ti fitove i gjallë e kur le jetën . . . .
Tue vdekur, si tue ruar, e nderte tatën,
se t' unjëtë afër teje t' lertit mbetën.
Kur hyjëzit ndër 'ta në kjell të patën.
sikurse dolli dielli, gjithë u zbetën,
si prej t' mëdhenjësh, nga të cilët zbrite,
në vënt të lumeris me gas u prite.
Të kisha shkop e mbështetim, o bir,
e besoja se m' dilte i ri nj' ylver;
për tyj s' më dukej më shtegu i vështir,
nuk rroja pa shpresë edhe se i prer,
më lehtësonje e m' bëje ti të lirë
të rëndët çë më dha jeta pa nder,
përse prej punës t' jatër u nuk pata
përveç se ngashërime e brenga t' glata

---

v. 185-192. . . . e nderove babanë si në jetë, si kur vdiqe; të vegjël mbetën të mëdhejt përpara teje, pse fitove emën; kur hyjt të patën në mes të tyne në qiell, u-sverdhën e u-shdukën ashtu si shduken përpara shkëlqimit të diellit, mbasi u prite me gëzim në vend të lumtënisë prej atyne burrave të mëdhej, nga të cillët zbrite.

çë=përemën lidhor. rasa kallz. zen vendin e uratës.

i gjallë=nji mbiemën që zen vendin e nji fjalisë kohore : sa qe gjallë.

e nderte=e kryeme e thjeshtë e foljes me nderue.

t' unjëtë=t' ulët, të vegjël; në Dibër thuhet i (e) unjët.

t' lertit=të lartët; të naltët; kemi nji infleksion tue u bâ a-ja në shumës e.

ndër ta=në mes të tyne.

v. 192-200. Të kisha mbështetje e kujtonja se po dilte, po shkëlqente nji ylber i ri për mue; pse të kisha mbështetje, me anë tande, vështirsit' e jetës nuk më dukeshin të randa, nuk jetonja pa shpresë, me gjithëqë isha i këputun; ti mi letsonje vështirsit që bota më dha për të më nderue, për të më shpër-

O Mino, o biri jim, u s' munt të t' kla
edhe të të vajtonj nuk kam fukji;
i lotëvet burimi mua m' u tha;
e jam si shkëmp i vetëm në shkreti,
mbi të cilin, tuke e thyer, rrëfeja ra,
mbi t' cilin po rëkon një zog i zi;
Isht zogu çë rëkon dhëmbja e pasosme,
çë çerdhe m' bë në zembrë të plakosme,
U thom, o biri i jim, se syt m' u terën,
përse trimat si ti nuk duan të klara;

---

blye, sepse prej punës nuk pash tjetër veç se të fshame e brenga të gjata.

besonja=kujtonja.

për tyj=me anën t' ande, pse të kisha ty.

i prer=i këputun, pse plak.

të rëndët=barrën me të cillën më ngarkoi bota për të më nderue; në këtë varg e n' ata dy që vijnë pas kemi nji ironi t' idhët të poetit

Jeta=bota; në këtë kuptim e përdorin të gjithë arbreshët, kurse **jeta, mbas nesh,** âsht tek ata **gjella.**

Për nder=për të më nderue, për të më shpërblye.

v. 201-208. Nuk mundem të të qaj, burimi i lotëve m' u-tha; jam si nji shkamb në mes të shkretinës, mbi të cilin ka ra rrufeja dhe e ka thye, shkamb mbi të cilin po rrënkon nji zog i zi; zogu që rrënkon asht plaga e pashërueshme që ka bâ çerdhen në zemrën t' ime të plagueme.

Zog i zi=zogu i zi âsht simbolli i zisë në poezinë elegjake popullore; më vijnë në mend disa vargje të njij kangës së tillë:

Ç' po këndon moi nanë nji zok i zi
Përmbi vorr moi nanë të gjalit ri,
Gjal' i ri moi nanë i pa martue . . . etj.

isht=âsht; ish=ishte; ndërto: zogu çë rëkon isht dhëmbja e pasosme.

m' bë=më bani.

plakosme=plagueme, varrueme.

përse s' m' e nxijte, po m' e sbardhe derën,
ç' e parë u shti për tyj për mbi të para.
Ai çë po ka mall bukën e verën
s' i ndahet kafshës çë përton tek ara;
rrojtëj' e 'tij me vdekëjen përglitet,
se ashtu për njerën si për t' jetrën s' flitet.
Me vehte thot ai se : Dua të jem
më mirë i poshtër, po i shëndosh e i gjallë,
se nder, i vdekur, si një trim të kem !
Më mirë n' dhe, me t' bukurat në vallë,

---

v. 209-212. Thom se sytë m' u-thanë, jo për tjetër veçse pse trimat si ti nuk duhet të qahen, sepse nuk ma nxive por ma sbardhe derën, shtëpinë, e cila, prej veprës t' ande, hyni në radhën e shtëpijave të para.

të klara=shumësi i emnit foljuer i gjinisë femnore : e klarë-a (i klarë i, e klarë-a, të klarë-t).

s' m' e nxijte=shif ma nalt fjalën nderte.

u-shti=hyni, kaloi, shkoi para, i foljes **shtënë** (shif mâ nalt) v. 40-45.

213-224. Ai që ka dëshirë për bukën e për venën nuk dallohet nga kafsha e plogët në arë; jeta e tij i gjan vdekjes, të dyja janë nji dorë, pse kështu si për njenën si për tjetrën nuk flitet; nji i tillë thotë me vehte : "Mâ mirë të jem i poshtër, por i shëndoshë, se sa, si të vdes, të kem nder si nji trim; mâ mirë për mbi dhe me dëfrime, se sa të lej. nuk e dij se ku, nji herë tjetër, në nji botë që nuk mund ta marr me mend; kushdo le të fitojë emën, unë kënaqem të gëzoj pa nder".

ka mall=don, dëshiron

bukën e verën=për bukë e për venë; nji njeri që kërkon të siguroje jetesën materjalisht.

s' i ndahet=nuk dallohet nga.

përglitet=i përgjet, i gjan, pse për nji njeri të tillë nuk ka randësi as jeta as vdekja.

nuk dij se te ku pamet i lem=nuk dij se ku i lem përsëri.

në jetë=në botë.

më hyn në ballë=marr me mend, kuptoj. "concevoir„.

v. 225-232. Krejt në kundërshtim me nji tip të tillë âsht Minushi, i cili si t' ishte i ushqyem me palcë drangojsh, mësoi

se nuk di se te ku pamet i lem.
në jetë edhe çë nuk më hyn në ballë! . . .
Kushdo le t' hypet e ndër hyj të rrie;
se vet kënakjem të trashgonj në hie!
Po ti sa i ndryshëm! . . . Si me palcë i ushkjyer
drangoi, ç' i vogël e kjysh kur u linde,
se jeta po ka dojë për t' u kryer
heret mësove, e me nje herë u binde
se atë nuk duhet fare me e kursyer
t' atdheut për grat e të së mirës gjinde;

---

shumë shpejt qysh kur u lind, se njeriu në jetë ka disa detyra, e me një herë i u-mbush mendja se jeta nuk duhet kursye për të mirën e atdheut e të njerëzve të mirë; u-suell ashtu si dijti i shkëlqyem nga nji pamje bukurije.

dojë=detyrë, detyrim.

heret=shpejt, me kohë.

se atë=jetën.

grat=të mirë; në kuptimin q' e përdor poeti fjala ka rranjën latine; kjo fjalë përdoret në Dibër e gjetiu me kuptim tjetër p. sh. akcilit i ka grat puna=i ka dukë; përdoret edhe në fraza të tilla: djathi i fortë (djathi peshe) ka grat, nuk harxhohet fort, i buti nuk ka grat.

i veksur=greqizëm, i ndritun, i shkëlqyeshëm; **ndoshta** ka të bâjë me fjalën vek-gu=korrnizë, atëhere i mveshun.

v. 233-240 Ajo që thom tashti nuk besohet ndër tregje, por atje ku burri nuk e ka humbë trimnin; ende nuk ishe afër gjashtë vjetve e atij që të pyeti se ç' ka deshe të bâheshe, kur të rriteshe i u-përgjegje: "ushtar për vend e për liri (due të bâhem), për nder t' atij vendi në të cilin gjeti shpëtimin fara e naltë prej së cilës jam, e për liri t' atij vendi që kam në zemër.

çë=atë që.

bujërin=bujar, buljer, bujëri=trimni, fisniki, nder.

s' e treti=me tretë=me humbë.

të gjashtave=të gjashtë vjetve.

megje=megje-ja, -e-të=kufi, cak.

kuj=atij që, konstr. it.=cui, a cui.

i math=âsht si ajo fjala mâ nalt "i gjallë„ nji mbiemën që rri në vend të fjalisë kohore.

e u solle me t' vërtetë ashtu si dije,
i veksur nga nj' e pame bukurije.
Çë thom nani s' besohet dot në tregje,
po atje ku burri bujërin' e treti :
Të gjashtavet nuk ishe edhe në megje,
e kuj se i math çë deje t' ishe t' pveti ;
"Ushtar për vënt e për liri u përgjegje;
"për nder të vëndit. te ku u fal shëndeti
të lartës farë prej të cilës jam,
e për liri t' atij çë n' zëmbrët kam„.

çë deje=ç' ka deshe, atë që deshe.

u-fal shëndeti=i u-fal shpëtimi; Shqiptarët, t' ikun prej Shqipnisë, gjetën shpëtim në tokën Italiane.

të lartës farë=farës, fisit shqiptar.

çë kam në zëmbrët=âsht toka ital.

v. 241-249. Fjalën e mbajte pse Shqiptari nuk foli kurr kot në shqipet; unë thom pastaj se vdekja nuk ka të zanë, thom edhe se bres mbas brezi do t' a quejnë të lumtun djaloshin, i cili, tue vdekë për nder të vendit t' onë, gjeti jetën përgjithmonë, pse përgjithmonë do të përmendet ai që e dëshmoi dashuninë për atdhe me gjakun e vet.

t' kota=fjalë të kota, të rreme.

gluha e jonë=gjuha shqip.

pran=konsek. prandaj.

dëshmim=dëshmi, "temoignage„.

v. 249-256. Lavdoju, o Pjanë, se u ndave nga të gjitha katundet t' arbresh, e të vendit të huej, lavdoju pse vrave nji djalosh trim të vogël e të lidhun, me gjith që zembrën e tij nuk e trondite nga friga, kështu shkole, rrëshqite mâ thellë mbrenda baltës e me të keqen t ande munde mâ të liqt, sa fitove emën gjith andej ku ka njerës të gjallë, pse je shpellë e mallkueme gjaksorësh.

trim=djalosh; këtu ka kuptimin e fjalës trim që përdorim ne, të guximtarit, të kreshnikut.

për dre=nga friga.

shkave=të shkarë=me shkelë, me rrëshqitë.

më të kekjit=mâ të liqt.

me të kekje=me veprën t' ande të ligë u-tregove mâ e ligë

E fjalën mbajte, o bir, çë kishe dhënë;
se kurr nuk foli t' kota gluha e jonë;
thom pran se vdekia fare s' të ka zënë,
edhe se bres pas brezi t' lum do t' thonë
djaloshin, çë për nder të vëndit t' ënë
tue vdekur, gjeti jetën për gjithmonë;
se për gjithmonë do t' ushtonjë zëri
i atij ç' atdheut deshmim me gjakun bëri.
Lëvdohu, o Pjanë, se nga gjithë u ndave,
sa ka arbëreshë e vëndi i huaj katunde,
se trim të vogël e të lidhur vrave,
ndonse zëmbrën e 'tij për dre s' e shkunde!
Ashtu më thellët brënda bajtit shkave,
e më të kekjit me të kekje munde,
sa nam fitove, ku ka jete e gjellë,

---

se gjith të liqt që ka bota, ua kalove gjith të liqve të botës.

ku ka jetë e gjellë=ku ka njerës të gjallë.

v. 257-254. Je gropë ferri e njoftun gjanë e gjatë, e kot me dreqin, që zotnonte mbi ty, luftoi nji herë nji gjuetar me fat, pse pemën e fitimit ja humbi koha, atëhere kur në farë e fisin e trimit dreqi vetë u-bâ lugat, e të fëlliqi me jargën e tij të helmueme, aq sa edhe i miri në gjinin t' and bâhet i keq, në qoftë se nuk ikën shpejt lark teje.

pisje=ferri; greqizëm=pissa.

e gjerë e gjat=nuk janë mbiemna, si mund të kujtohet, por janë dy ndajfolje vendi që duen me thanë gjithandej.

ç' isht mbi ty i zoti=që sundon mbi ty.

një gjator=Minushi.

mundësis=nuk ka kuptimin e "possibilité„ që përdoret sot në gjuhën e re t' onën. por atë të "victoire„, fitim, të mundun.

në heret=në qoftë se shpejt.

edhe tutje=tutje lark, lark teje.

Në këta vargje poeti do të thotë se kishin ardhë kohë të liga kur sundonte, kur mirrte e jipte dreqi, e prandaj humbi edhe Minushi.

v. 265-272. Pjanë, turp i fisit shqiptar, turp i Siqilisë, që me mundim të duron! Mbassi italjani nuk po të vërsulet e të të përvëlojë zjarri i tij, Kodra e Petritëve i u-bâft garth atij lumi që buron në Hon, sa, ndër valët që piqen me tërbim, të mbysë ai në gjinin t' and çdo njeri!

se je gjaktarësh e mallkuame shpellë.
Je pisie gropë e njohtë e gjerë e gjat,
e m' kot me Dregjin, ç' ish mbi tyj i zoti.
luftoi një herë një gjator me fat,
se pema e mundësis ju prish nga moti,
kur Dregji n' farë t' 'tij u bë lugat
e me jargë të helmuarë të ndoti;
sa i miri edhe tek ti bënet i lik,
në herët edhe tutje s' vete e jik.
Ah Pjanë, marrë e fisit arbëresh
edhe e Siçilies, çë me zi t' duron!
Me kjënë çë s' të bie litiri ndesh
e zjarri i 'tij edhe s' të përvëlon;
e Petritëvet Kodra bëft kjë tesh
garth atij lumi çë ka grykë n' Hon,

Këta tetë vargje janë përkthimi, po thuej se fjalë për fjalë, i mallkimit që Dante Alghieri i lëshon Pizës, në episodin e bukur të "Conte Ugolini-t„.

Për t' i krahasue dy copat po sjell këtu vargjet e Dantes në origjinalet e përkthimin e Koliqit.

Ahi Pisa, vituperio delle genti
del bel paese là dove 'l si sona,
poi che i vicini a te punir son lenti,
muovasi la Capraia e la Gorgona,
e faccian siepe ad Arno in su la foce,
si ch' elli annieghi in te ogni persona!

(D. Alighieri-Divina Commedia Inferno XXXIII) vargjet 79-84.

Ja edhe vargjet e përkthimit të Koliqit :

Ah, ti Pizë, turp e marre e gjindve t' asaj krahine të bukur ku **si-hi** kumbon, mbassi qi fqîjt t'uej po ngjasin me të ndëshkue, le të dynden Kapraia e Gorgona e le t' i bâhen pendë Arnos kështu qi ai mbrênda teje te mbysi ç' do njeri.

litiri=latini, italiani.
bie ndesh=me ira ndesh, me i u-vërsulë për ta shkatrue.
kjë tesh=qysh tash.
Kodra e Petritëve=nji vend në Pjana dei Greci.
n' Hon=tjetër vend në Pj. dei Greçi. Si mbas pohimit të të

sa ndër valë çë pikjen me mëri
të mbytnjë ai tek ti çëdo njeri !
Ndër brigje t' ashprë edhe ndër kodra t' shterra,
një fushë e shkretë, çë s' di më të korra,
te ku nuk gjejën më t' kullotur berra,
te ku të gjallë s' ka përveç se sorra
tek airi i kekj edhe shtërpinj ndër ferra,
çë gërmadhevet rrin gjith' anësh torra,
o Pjanë ke të bënesh, në mos klafshe,
në shkjyptarisht nga faji mos u lafshe !
Me t' madhe t' bëra dashuri një kezë,
e glëmbash m' e shpërbleve me kurorë;
ari me pënj' u t' ënda e napë e rezë,
e jo se kleve n' njohëje e përkorë,
po më paguajte me mbulonjë t' zezë;

---

ndritunit Papa Paolo Matrangës, në kishën unite t' Elbasanit, Hon-i âsht nji grykë e madhe në P. d. Gr., kah buron lumi.

mëri=në dialektin e P. d. Gr. kemi fjalët **mëri** e **mëni** me kuptime të ndryshme : mëri-a ka kuptimin e fjalës inat, zemërim; kurse mëni-a përdoret në kuptimin që përdorim edhe ne fjalën mëni; edhe këtë e kam marrë nga i nduni Matranga.

v. 273-280 O Pjanë, ti do të bâhesh nji fushë e shkretë, me brigje t' ashpra e me kodra që s' prodhojnë, ku nuk ka ç' të korrish, ku nuk gjejnë kullosë berrat, ku s' ka tjetër gjâ të gjallë për veç se sorra në mes të ajrit të keq dhe shtërpinj nëpër ferra e që rrijnë rreth nëpër gërmadha, (kështu do të bâhesh) në qoft se nuk qan, në qoft se nuk e lan fajin shqiptarisht d. m. th. të marrish gjakun, të dënojsh veprën e atyneve që u shitën ke i hueji dhe që më vran Minushin.

t' shterra=të thata, që s' prodhojnë; me u-shterë, me shterue, dy folje që përdoren mâ tepër për të tregue të thamit, të shterunit e nji burimi : ka shterë kroi, ka shterue kroi.

të korra=të korruna, të kosituna.

të gjallë=shpirtna të gjallë.

Torra=rreth, për qark.

ke të bënesh=e ardhshmja e foljes me bâ, do të bâhesh; arbresht thonë : kam e bënj, kam e bëhem=do të bâj, do të bâhem, d. m. th. për kohën e ardhshme përdorim si ndihmëse, në kohën e tashme foljen me pasë.

nuk ruajta për nder t' ënd as vapë, as borë,
e ti si kur se s' gjegje edhe se s' pave;
sa më të desha, e djalin ti më vrave.
Djalin më t' math më vrave ashtu si s' vritet
nj' armik nga ata çë fare arsimi s' kanë
ndër t' egrit pyje, ku nj' i huaj s' afritet,
po çë të ndershëm e të mirë janë,
për turp të fisit ç' i pazot po rritet
e në katunde e në kjytete t' anë . .
O Mirditasë, o burra, e ku j-u kisha ? . . .
Në kishët klenë ju, në zi nuk isha !
N' u kishët ndodhur ju, meca të malit,
n' u kishët ndodhur ju, trima të pyllit,
çë mlidhij përmbi majën e Shën Palit,
s' do t' isha n' t' errët për t' u shuar të hyllit,

---

në=në qoft se.

Shkjyptarisht=në mënyrën e Shqiptarve, trimnisht.

v. 281-288. Me dashuni të madhe të bâna nji kunorë e ti mâ shpërbleve me kunorë gjembash; me penjë ari un t' enda nji pëlhurë e tentene e ti nuk qe mirnjofse, por më pagove me nji mbulojë të zezë; nuk shikova për ty as verë as dimën, e ti veprove sikurse nuk ndigjove e nuk pe; un të desha aq sa mâ tepër qe e mundun, e ti më vrave djalin.

kezë=kurorë, por që e mbajnë vetëm gratë, nuset.

rrezë=tentene, dantela.

n' njohëje=në mirënjoftje.

e përkorë=fjalë e re për poetin, "sobre„, "parco„.

ruajta=vërejta, shikova.

s' gjegje=me gjegjë (Dibër me xhexhë) me ndigjue. Serembe thot :

gjegje, vashë, kangjelnë e parë,
çe të thotë një djalë buljarë . . .

sa më=sa mâ tepër.

v. 289-294. Ti më vrave djalin mâ të math ashtu si nuk e vrasin anmikun ata që nuk kanë farë arsimi, nuk e vrasin ndër pyje t' egra, ku nuk afrohet nji i huej, por që janë të ndershëm e të mirë, ti ma vrave djalin për të turpënue fisin t' onë që po rritet pa të parë nëpër Katundet e nëpër Qytetet t' ona.

nuk do t' klahesha sot për fat të djalit,
e s' do t' më shihte me fytyrë të dyllit,
ulkonja e Merkut, çë po ka gëzim
kur njërëzit i heth në ngashërim.
E i math ë ngashërimi, o bir, çë m' mbyt
sa e madhe gozhda çë në gji m' u fut,
e dhe në i parrëfyeshmi fat i jyt
për trimërishte këngëtarin ngut,
me nye të klari të lëvdonj në fyt,
e kënga brëngën t' ime nuk e sbut,
se e nderit t' ënd e larta ligjiratë
atdhetarin gëzon, po ndryth një tatë.
Verteta m' ndryth, po m' bën si madhështor
se kurr trima si ti s' u kishën par,

---

s' afritet=s' afrohet.

për turp . . .=âsht fisi Shqiptar.

v. 295–304. Poeti kur sheh se as njeri nuk po del të dënojë vrasësit e të birit, u thrret Mirditasve, trimave Shqiptarë, të cillët këtë vepër barbare nuk do ta lijshin pa e dënue.

në kishët=po të kishit ndodhun ju.

meca= trima të lehtë; përdoret edhe në Dibër: mejca, me dorë!

t' errët . . . hyllit=vdiq djali, u-shu hylli që ndriçonte jetën e poetit.

nuk do të klahesha=me u-kla, me u-qa, me u-ankue.

me fytyrë t' dyllit=të zverdhun.

Ulkoja=personifikimi i veprës barbare të banorëve, bolçevikve të Pjanës.

e Merkut=âsht vendi ku arbresht kanë themelue P. d. Gr; mâ posht do të shofim:

E te Merku Pjanën vu ?

v. 305–312. I math âsht ngashërimi i em, sa e madhe âsht gozhda qi m' u ngul; dhe në qoftë se fati i yt i parëfyeshëm e shtyn kangëtorin për të këndue kangë trimnije, unë të lavdoj me nyje të qami në fyt . . . pse lëvdata e nderit tand e gëzon atdhetarin, po, por, e mbytë babanë.

për trimërishte=për kangë triménije.

ligjiratë=fjalë me kuptim të lavdimit.

ndryth=shtyp, "opprimer„.

si ti Romak edhe më një Arbëror,
sa t' vjetrës derë, çë nuk pati t' shar,
i shtove nam, tue rënë mundësor;
tue dhënë për atdhe jetën e shtrejtë,
të flamurit t' liris nder klinde t' shenjtë.
E patundëshme në vend e mjera nënë
as flet, as kla, nuk gjegjet e s' renkon,
e sbetë n' fakje, si dimbrore hënë,
kur i borës savani dheun pështron :
me sŷ të haptë e nga një mërë të zënë,
vërren në t' mbrazët e mosgjë shikjon;
po i ngjethet shtati her' e herë e fshan :
o bir, o djali i jim, përse më t' vran ?
Si zogjëzit çë trembi gjëma e res,
kur kris rrëpira me rrembim në maj,

---

v. 313-320. Me të vërtet më shtyp, por për nji herë më ban edhe krenar e madhështor, pse s' janë pá kurr trima si ti Romak dhe për nji herë Shqiptar, sa i shtove emën shtëpisë së vjetër, tue ra fitues.

Poeti, i dëshpëruem deri në fund për humbjen e të birit, gjen gjithënji nji farë ngushëllimi, kur kujton se Minushi, me veprën e tij të rrallë, i dha nder jo vetëm familjes së vet por gjith fisit nga i cilli zbret, fisit shqiptar.

më një=bashkë, për nji herë, po n' at kohë.

t' vjetrës derë=do të shohim mâ poshtë, në pjesën e IV. të këtij poemthi se poeti thot, pak si tërthurazi, që familja e tij zbret prej atyne familjeve të vjetra shqiptare që zunë vend në Pjana dei Greci, mbassi ikën prej Shqipnisë; prandaj këtu dera e vjetër mund të jetë familja e Skjironjëvet, e mund të jetë edhe i gjith fisi Shqiptar.

mundësor=mundës, fitues; vërtet vdiq, vërtet humbi materialisht, por fitoi moralisht.

Maja e Shën Palit=do të jetë vend të Shqipni.

v. 321-328. Nana e mjerë pa lëvizje... nuk ndigjon,... e verdhë si hanza e dimnit, kur çarçafi i borës, mbulon tokën... me sy të ngulun në nji mejtim.

Nuk gjegjet=nuk ndigjon.

dimbrore=e dimnit, dimnore.

dridhen nën t' ëmës në kerthi t' foles;
të vegjëjit ashtu rrin nd' anë asaj,
me gluhë t' marrë nga përshpjeta e ndres
edhe s' guzojën sa të bëjën vaj
s' guzojën t' pyesin për më t' madhin vlla;
po për të madhe t' zezë zëmbra i kla.
Tue shkulur kript e bardhë e t' shpupurisur,
plaka gjyshe vajton e thot .... O bir,
dy herë bir, çë nuk m' u kishe nisur,
po thuaj se n' dhrom çë zëhet me pahir
e kleve mbrënda varrit gorromisur,
si mua, ç' akjë të prëhem kam dëshir
nuk deshi yn' Zot e tyj rrembeu në kjiell;
si në rushgjer çë gjithësin pështiell ?
E thom û vet; ... e ju çë n' shpi më vini,

Savani=çarçaf, napë, sipërfaqja e borës; nga Greqishtija Sabanon; Arabisht Sabanijat (pëlhurë që bahet n' Arabi, në qytetin Saban, afër Bagdatit)

Pështron=mbulon në të gjitha anët; nga për e shtron.

v. 329-336 Si zogjt që friksoi bubullima e resë, kur shpërthen shtërgata, dridhen në fund të folesë nën t' amën, të vegjëlit ashtu rrijnë afër saj, pa gojë nga friga e pa pritun e s'guxojnë të bajnë zâ... por u qan zemra për fatkeqsin' e madhe.

Gjëma=krismë, bubullimë.

Rrëpira=shtërgata. merë=helmë, pikllim : mejtim, ndoshta nga mënerë.

nën t' ëmësë=për nën t' amën.

kërthi-ni=mesi, fundi i foles.

nd' anë asaj=pranë saj, s' amës.

përshpjeta e dres=shpejtësija, të pa pritunit e frigës

me gluhë t' marrë=me gjuhë të marun, të zanun, pa folë.

sa të=që të, me qëllim që; konstrukt që ndodhet shpesh ke Skiroi; asht e P. dei Gr.

i kla=për i-në vend të u së kemi folë ma nalt.

v. 337-344 Mbas nanës vjen në sqenë gjyshja plakë me flokë të ngatrueme e të bardha e cilla vajton të nipin që qe gremisë në vorr shum i ri; " si vallë zoti nuk më deshi mue, pyet plaka, që kam dëshirë të prehem, por të rrëmbeu ty në qiell, o

për krye t' shëndosh edhe t' më ngushlloni,
ju falem nderës për të mirë ç' kini,
po fjalë për me m' sbutur mos kërkoni;
vetëm j-u lutem, në gjagjë edhe dini,
të mos m' fshihni dot e të më thoni :
Se ç' faj i kisha hores t' ënë i ngrati,
çë zembrën më këputî e shpirt nuk pati ?
Ç' i bëra Pjanës, çë kështu m' paguan ?
... Me punë, e jo me dokërra, e nderove.
Ç' i bëra Pjanës, çë kështu me gjuan ?
... Ng' ata ç' e deshën lik nga herë e mprove.
Ç' i bëra Pjanës, çë haren më shuan ?
... Të kishte dritë e mirësí u mundove.
Nga t' Pjanës pra t' im bir përse m' e vran ?
... T' e vran të kekjit; po të mirët klan.

---

bir? e të rrëmbeu si nji tufan që mbështjell gjithë botën" ?

kript=flokët.

shpupurisun=të prishun, të ngatruem.

dhrom-i=rruga, greqizëm.

Gorromisun=gremisun, greqizëm.

rushgjer=tufan "turbillon", turqizëm që përdoret edhe n'Elban; e gjetiu.

v. 345-352 **Për krye t' shëndosh**=janë fjalë që përdoren kudo, si në Dibër për të ngushullue nji njeri kur i ka vdekë ndonji i dashun: shkoi për krye shëndoshë ke akcili; në Jugë thohet: **vete për të folur.**

në gjagjë dini=në qoftë se dini ndonji send.

Horës=P. dei Gr. quhet edhe Hora e arbreshve; fjala horë përdoret si mbas vendit në kuptim fshati qyteti a vendi përgjithsisht.

v. 353-360 Këtu poeti fillon nji vajtim me pyetje e përgjegje mu âshtu si bajnë gratë në disa vende të Shqipnisë kur vajtojnë ndonji të vdekun; këtij vajtimi në Dibër i thonë "të rrënditun", për shembull akcilja rrënditi sot, e rrënditi akcilinë të vdekun; fjala "të rrënditun, rrënditje" vjen nga të vumunit me radhë, nga të rrënditunit e fjalëve.

gjuan=goditë, qëllon

deshën lik=deshën keq.

Vjen prifti e me të but më çuçullis :
... Të dhëmbesh ke të drejtë .... E burrit isht;
Se, për të zezën çë kështu t' skotis,
egrësirës edhe i përkjethet misht.
Por Zoti atë çë do në dhe e kërdis,
t' i falnjë vënt më t' mirë në lulisht,
ku djali i jyt trashgon e ka shpërblim
se i bëri atdheut e Perendis dishmim.
... Ti flet me t' ëmbël; po, ore prift, më thuaj,
përse me krykj, pas dokavet fetare,
të djalit, çë kë e vriste Zotit truaj,
kurmin s' përsolle ti në pushimtare ?
Engjëjish radhë nuk duron të huaj
e urata e jime atij s' i duhej fare.
Lutet klisha për 'të çë fshan për kjiell,

---

nga hera=çdo herë, gjithënji.

nga t' Pjanas=nga banorët e Pjanës.

v. 360-368. ... ke të drejtë të kesh dhimbije, vuejtja âsht për burra pse për fatkeqsin që më brengos edhe egërsinës i ngethet mishi, por Zoti e shkatrron në këtë botë atë që do, me qëllim qi ti fali vend mâ të mirë në lulishten e vet, ku yt birë gëzon pse e dëshmojë dashunin e atdheut e të zotit.

Çuçullis=fjalë onomatopeike, banë çë-çë në vesh.

e burrit isht=âsht gjâ për burra.

skotis=greqizëm, terratis; brengos.

kërdis=turqizëm, me prish me shkatrue.

v. 369-376. Ti o prift, flet me të butë, po pse nuk e përcolle me kryq në vorrezë trupin e t' im biri, i cili po ja porositte Zotit ata që po e vritshin ? — Radha e Engjëjve nuk pranon t' huaj ... kisha lutet vetëm për ata që fshajnë për qiellin, për Zotin, por jo për ata që hyjnë mbrenda diellit të pa fund, shkëlqimit pa mbarim.

kë e vriste=ataa që po e vritshin.

pushimtare=neologjizmë e poetit, vorrezë.

Trupin e Minos e përcollën nji radhë engjëjsh, prandaj prifti thot se nuk ishte nevoja e lutjes, uratës së tij.

për të çë=kisha lutet për atë që do ta fitojë qiellin, e jo për Minon që e ka fitue.

jo për k' u llum në të pasosmin diell.
Askurr me fjalët u shërua lavomë,
në fjalë t' mira vënt të mirë zën;
degën ç' u tha s' e bën pamet të njomë
gjith ujët çë kërnallëja po nxën,
Dallëndysheja prap do t' m' vinjë n' dhomë;
po të vdekurit varrin nuk e lën;
më t' shkrim të borës bula do t' shpërthenet;
po vate djali i jim e më s' këthenet!
Kur kjet më shumë gjak zëmbra e dërptuame
prej gozhdës çë n' atë thellët u kreth,
një fluturëz' e bardhë e e përaruame
më vjen, si lule çë ka frymë e breth;
ajo, të m' përgëzonjë e dishiruame,
po si flakës ç' e helkj, më sillet reth,

---

jo për k'u llum=jo për atë që i hyni i tanë mbrenda; llumem futem mbrenda.

v. 377–384. kurr nuk âsht shërue plagë me fjalë, me gjithqë fjalët e mira zanë vend të mirë; dega që u-tha nuk njomet mâ as nga ujët e gjith hapsinës së detit.

Lavomë=greqizëm laboma, plagë.

në=me gjithqë.

pamet=përsëri.

Kërnallëja=vendi që zen ujët e detit, sipërfaqja e detit.

bula=gonxhe.

v. 385-392. kur nxjer zemra e dërptueme mâ shum gjak prej gozhdës që m' âsht ngulë thellë në zemër, më vjen nji flutur e verdhë dhe e prarueme, si nji lule me shpirt, endet andej e këndej e e dëshirueme të më limojë si nji flakë që unë e tërhek, më sillet për rreth, e jeta më mblidhet ke sytë, shpirtin t' and e njof në flutërën që dridhet.

kjet=nxjerr, lëshon.

u kreth=me u kredhë, me u zhytë; poeti për të tregue dhimbjen e madhe që ka, zgjanon kuptimin e fjalës, pse gozhda ngulet, nuk zhytet.

helkj=tërhek.

v. 393-400. plaga më egërsohet e dallgë më hypin në krye;... me dëshirë vras ata që njof. Poeti këtu nuk ban nji gja të

e si te syt, o bir, jeta më mlidhet,
shpirtin të njoh te flutura çë dridhet.
E varra m' egërsonet e suvalë
te kryet më hypen e të kukj po shoh;
gjaku më zien në dej e grah pa fjalë;
me dishirimin vras ata çë njoh,
ata çë di se dorë m' vën mbi djalë,
ata çë nuk u ngopën dhe si u ftoh,
e po si bulku, pas çë rushin vjel,
pa përdëllim të vdekurit u shkel.
Shkjyptari at' herë flet tek û e Sikani:
... Për ah me marrë, mos ja kij njeriu,
se i zot të prëhet pa kujdes te stani,
kur ulkun fal, nuk munt të jete bariu;
tjetras, me t' mirë nuk u sbut dardhani,

---

teprueme si kurse ngjet shumë herë në poezi, por përshkruen me të vërtet të vërtetën : vrasësit e Minushit, si dëshmojnë njerës që kanë ndodhun në Pjanë natën e vrasjes, nuk u-ngopën t' i ngulin thika edhe atëhere, kur kishte dhanë frymën e fundit.

suvalë=dallgë.

Grah=thrres.

dhe si u ftoh=edhe si u ftof trupi i të vdekunit.

pa përdëllim=pa mëshirë.

v. 401-408. Atëhere mue më flasin Shqiptari e Siqiljani : - për të marrë gjakun mos ja kij hatrin kurrkuj, pse bariu, që e fal ujkun, nuk mund të prehet pa shqetsim ke stani; me fjalë të tjera, tue marrë me të mirë nuk zbutet i poshtri. se kot bien mbi gur vesa e shiu, se nuk e zbusin si kurse nuk zbutet me të mirë i poshtri. Mer gjakun . . . edhe mund të gjejsh ndonji farë ngushullimi

Sikani=Siqiljani; emni i vjetër i Siqiljes âsht "Sicania„.

ah=hak, gjak.

mos ja ki njeriu=mos ja ki hatrin kurrkuj.

tjetras=me fjalë të tjera.

dardhani=i poshtër.

nuk u-sbut=e kryeme e thjeshtë për të tashmen.

ndo=ndonji, ndonji farë.

mënt=mund.

se m' kot po bien mbi gur e vesa e shiu....
Mirr gjakun t' ënt, o burrë, e nder do t' kesh,
edhe ndo lehtësim ashtu mënt të gjesh.
Isht turp në t' prërët t' lësh ata të likj
ç' akjë sa u ra në dorë t' bën të kekj;
prej teje do të shporren shokë e mikj
do t' thonë se s' ka shpirt e djelmë e plekj.
Të mos t' ket marre fisi pra u përpikj;
zërin e gjakut çë thërret po gjekj;
e rreku pas të drejtës çë t' u dha,
se pandëshkimi i bën zëmbrakë ata.
Po thot im bir: — Ka ngushëllim i marri
kur merr të drejtën çë nga gjaku i vjen;
po i t' mjerit tatë e i mëmës t' ime zjarri,
çë moti t' vogëlsonjë nuk vëlen,

---

v. 409–416. âsht turp t' i lâsh të qetë ata të këqij që të bânë keq aq sa kishin në dorë; shokët e miqt do të largohen prej teje, djemtë e pleqtë do të thonë se s' ke shpirt; përpiqu të mos ketë turp fisi, ndigjo zanin e gjakut që bërtet e mundohu mbas të drejtës që ke, sepse po s' i ndëshkove ata të trimnohen.

në t' prërët=në prehje, qetësi; emën foljuer i gjinisë asnjanëse, nuk âsht mbiemën në shumës si mund të kujtohet; këtë na e tregon edhe parafjala në.

gjekj=ndigjo.

zëmbrakë=neologjizëm e poetit.

v. 417–424. im bir thot: I marri ngushllohet kur merr shpagimin që vjen nga gjaku, por zjarri i t' im eti e i s' ime amë, që koha nuk vlen për ta zvoglue, do të shuhet vetëm atëherë kur të jenë në vorr, ku shpirti i len më nji anë sendet e botës, para se të gjejë atë pushim që kot ka kërkue në jetën e parë.

moti=koha.

vëlen=vlen.

të dheshmet=neologjizëm e poetit, bâmë nga fjala **dhé**, sendet e kësaj bote, dëshirat e shpirtit në këtë botë.

lëren=liron, len.

ata t' pushuar=tjetër emën njejës i gjinis asnjanëse (kryefjalës âsht shpirti edhe në vargun qi vjen mbas).

do t' shuhet vetëm kur të jen te varri,
te ku shpirti të dheshmet i lëren,
më para se të gjenjë ata t' pushuar,
çë m' kot te jeta e parë ka kërkuar.
E gjegjem t' ëmblin zë çë më thot: — Tatë,
shpirt-math të jesh, ashtu si ti po kleve,
kur me të likj e zëmbrëzesë u mate
e mbi t' pushtuamit bujëri rrëfeve.
Dëfto se me të drejtë bir më pate
e se mësimi për dërgatë u leve;
se të dhëmburit t' at më lart dil pran,
tue falur gjithë ata çë mua më vran.
Ai ç' armikun pas uhas e vret,
nuk ndahet as për pak prej njerëzis;
po kush e fal atë, fisnik si mbret,

v. 425-432. Unë e ndigjoj zanin e ambël . . . — të jesh shpirt-math, ashtu . . . kur u-mate me të këqijt, e mbi të mundunit rrëfeve burrni, fisniki; diftou se më pate bir, e se leve për të qenë shembull, apostull mësimi; pastaj dil përmbi dhimbjen t' ande, tregoju mâ i fuqishëm se dhimbja vetë.

gjegjem=âsht vepruese, jo psore, ndëgjoj.

bujëri=burrni, fisniki "noblesse„.

për dërgatë=nga folja me dërgue, këtu ka kuptimin e "mission„.

v. 433-440. Ai që vret anmikun si mbas detyrimit që i ka, nuk dallohet aspak prej njerzve të tjerë; por ai që e fal anmikun ngrihet si mbret mbi të parët e trimnisë; pastaj ai që e do si vëlla të vërtetë i afrohet Perëndisë ma tepër se të tjerët. Ai i qaset Perëndisë sa shpirtnat të tjerë që i rrijnë pranë, por që s' dijnë se ç' âsht dhimbja si njerzit që vdesin.

pas huas=si mbas hakut që të marri.

nuk ndahet=nuk dallohet.

më se=ma tepër se.

i jesin=i rrijnë.

v. 441-448 T' i ngremë nji përmendore të qëndrueshme ma tepër se guri e se bronxi, me durimin t'and, me dashunin t'ande, me faljen t' ande, që t' i hapen syt atij që i ka e nuk sheh, atij që nuk beson në të mirën, atij që thotë se nuk e njef Perëndinë,

çohet për mbi të parë t' trimëris;
ai çë pran e do si vlla t' vërtet,
më se edhe t' jerë i kjaset Perëndis;
sa shpirtërat, po thuaj, çë nd' anë i jesin,
po çë dhëmbëje s' din si ata çë vdesin.
Një të kjëndroshme pra në dhe kujtesë,
më se guri e se brunxi, ti më ngreh,
me durim, me të dashur, me ndëjesë;
t' i hapen syt atij ç' i ka e nuk sheh,
atij çë në të mirë nuk ka besë,
atij çë thot se Perëndin s' e njeh;
nga nata ç' e pushton ai t' lironet,
të bindet, të pendohet, të kjërtonet.
O shpirt i djalit t' im, ç' atij çë t' deshi,
sa vehten kurr, jo më s' i ndahe n' gjumë;
o shpirt i shejtit t' im, çë kuj të veshi,
n' ëndërrë malli, bukurie me t' shumë,
një fjalë të hieruashme i bie te veshi
edhe zëmbrën i zhgreh ç' u tha si gumë,
lutu për 'të kj' ai të njihet druri

---

të lirohet nga nata që e mbulon, të bindet, të pendohet, të ndreqi gabimin.

të kjëndroshme=të qëndrueshme.

kujtesë=përmendore.

më se=ma tepër se.

ka besë=kam besë=besoj.

v. 449-456. O shpirt i t' im biri, që nuk i ndahe ma kurr në gjumë atij që të deshi sa s' e deshi vehten kurr, o shpirt i të shejtit t' em që atij që të veshi në andërr dashunije, me bukuri të madhe. nji fjalë të shejtë i sjell në vesh e zembrën i zbut që u tha si shkamb, lutu për të që të njifet ai druni, që të solli ty si pemë për të habitë botën.

atij çë t' deshi=âsht poeti vetë.

jo më=asnjëherë.

kuj=atij që, it. cui, a cui.

malli=dashunie.

bukurie me t' shumë=me shumë bukuri.

të hieruashme=të shejta.

çë tyj, si pemë për të bindur, pruri.
Syzit e tu të butë e të mëdhënj,
do herë të mejtuamë e do në gas,
përpara i kam, kur ec edhe kur ndenj,
460 në punë edhe në shtrat, kur hesht, kur flas.
Po shpresë edhe të plotë, u mënt' t' ushkjenj
se do t' pikjemi prap, o para, o pas ? . . .
Të Zotit t' ënë të posaçëm hir,
prej teje lutës, në se patsha, o bir !.
465 O Mino, o bir i dashur, më beso
se t' falë s' jam i zoti të dhuronj
bishavet t' egra, çë të bën ato
të kekje e dhunë, çë me tmer kujtonj.
Jam burrë me gjymtime e, domosdo,
470 i glas atyre ndër të cilët rronj;

---

zhgreh=i sbut.
gumë=shkamb.
lutu për 'të=poeti kërkon që Minushi të lutet n' atë botë për të jatin.
druri=poeti vetë âsht druni nga i cili leu Minushi.
pemë=Minushi.

v. 457-464. Syt e tu i kam përpara nga njiherë në mejtim nga njiherë të qeshun, ... kur rrij . . . . Po a mund të mbaj shpresë të plotë se prapë do të piqemi qoftë pára qoftë mbrapa?

Falënderim të posaçëm Zotit t' onë, në e paça, me ndërhymjen t' ande, këtë shpresë, o bir.

do herë=disa herë.
ndenj=me ndenjë, unë rri.

v. 465-472. O bir i dashtun, besomë se s' jam i zoti t' u dhuroj faljen bishave t' egra, nuk mund t' u fali atë ligësi e atë turp që të bânë ata, ligësi e turp që i kujtoj me tmerr; unë jam njeri me të meta, e doemos u gjas atyneve me të cilët jetoj; ndjenjat më tërhekin si të tjerët, me gjith që mund t' i urdhënoj nga nji herë,

t' falë=falje, të falun; "pardon„.
gjymtime=mëkata, të meta.
i glas=u gjas.
kam urdhër=mundem t' i urdhënoj, t' i shtroj.
ndo herë=ndonji herë.

ndienjat më ngrehin mua, si ngrehin t' jerë,
ndonse kam urdhër për mbi 'to ndo herë.
Po e dhëmbjes t' ime do të djek te flaka
sa n' zëmbrët kam mërije e hidhërimi;
e t' mirëvet, për tyj, dhe më se e paka,
në t' kryem do t' hynj më mbrënda se te shkjimi;
e ashtu, si zogu çë shpëton nga maka,
do t' vinj të rri ku gjën kurorë trimi,
prej mallit çë të kam gjith i kjëruar,
me tyj nga gjaku për atdhe t' hieruar.

v. 473 480. Unë do të djek në flakë gjith zembrimin e gjithë hidhnimin që kam në shpirt, e me veprën t' ande do të hyj mâ mbrenda pragut të përsosmënis se ajo pakica e të mirëve, e kështu si zogu që shpëton nga vishtulli, nga dashunija që kam për ty gjith i qëruem, do të vij të rrij . . . , do të vij të rrij me tyj që je i shejtënuem nga gjaku i derdhun për atdhe.

dhe më se e paka=edhe mâ tepër se pakica.
t' kryem=përsosmëni, "perfection„.
shkjimi=shkamb i derës, pragu.
maka=vishtulli, langu i pishës.
t' hieruar=të shejtënuem.

II. Janë katër tingllime, në të cilët poeti, me theksa që të prekin me të vërtetë mu në zemër, mallkon fshatin e tij, Pjanën, për të zezën që i punoi tue i vramë të birin; por në tingllimin e katërt, që për mue âsht mâ i bukuri, duket se këto namë që heth poeti zbuten pak, si do të shofim në analizën e imtë të tingllimit.

v. 481-494. **Tingllim i Irë :** Katund i poshtër tashti, aq sa mâ i naltë mâ para, që me ligësi e nxive vehten për përherë, aq sa ti nuk mund t' a lajsh mâ vehten; mbas turpit le të bjerë vdekja mbi ty !

Kurr mâ në gjinin t' and mos bîftë farë shëndeti, as mos haptë lule me erë të kandëshme, mos paç mâ të mirë e të mbarë, por u-bâfsh tokë e shkretë, e thatë, e mjerë !

Aty ku rrijnë tashti bishat që polle për mâ të madhin turp të gjindes shqiptare, ndër muret e rrëzuem, të zanë vend gjarpijt e zi e nepërkat helmuese, pse pa shpëtim të ka zanë nama e

II.

1. Katund i poshtër, sa më i lart më parë,
çë me të kekje u bëre i zi për herë,
sa më nuk munt të kesh fakje të larë,
pas dhunës, për mbi tyj vdekëja t' bjerë!
Mos bift më kurr tek ti shëndeti farë,
as lule mos u hapt me t' ëndëshm' erë;
mos patshe më të mirë edhe të mbarë;
po u bëfshe tokë e shkretë, e thatë, e mjerë!
Aty ku rrin nani bishat çë shtrue,
për turp të math të gjindes arbërorë,
strofull të ken, ndër të rrëzuarit mure,
gjarpinjë t' zesë e nepërka helmore;
përse nga nëma, pa shpëtim, u zure,
nga nëma e flaktë e kuj ti zëmbrën shkjore.

2. Në bota e tërë rrahet anë e mb' anë,

atij, të cilit i shqore zembrën.

sa më=aq sa mâ tepër.

të kekje=të ligë.

shëndeti=këtë fjalë poeti e përdor në kuptim shpëtimi e shëndeti; këtu ka kuptimin e dytë.

nani=tashti.

shture=me shturë, të pjellun me forcë, me shtërngim.

v. 494-508 **Tingllim i lltë :** Po ta rrafish botën an' e kand nuk gjindet vend si ti për të mos u-zanë me gojë; për ty janë anmiq e të huej të gjith ata që nuk u-kursyen të të napin emën; gjithë ata që të bâjnë mirë gjejnë keq prej teje; detyrat që ke kundrejt tyne ua lan tue i zanë me gurë ata, se dolle banesë egërsinash e bishash, gjakpirësh që e fëlliqën emnin t' onë; për të të sbardhun faqen u-mundova gjithnji edhe damtova vehten t' ime, pa pritun kurr nga ti ndonji send mâ vonë; por ti, për të më shpërblye, më more shpirtin, pse më vrave djalin, ashtu si e vranë Krishtin ata që nuk qenë mâ tepër fajtorë se ti.

në=po të, në qoftë se.

rrahet=me rrah botën, të kërkojsh botën.

për të mos thënë=që nuk meriton të përmendet, të zihet në gojë, pra i lik.

Sa t' mirë : . .=gjithë ata që të bâjnë të mirë, sa janë ata

nuk gjëndet vënt si ti për të mos thënë.
Për tyj armikj' e t' huaj' ata po janë
çë dritë e nam nuk u kursyen me t' dhënë.
Sa t' mirë t' bëjën tyj, të kekjë po kanë;
detyrët lan me gurë ata tue zënë;
se dolle t' egrish e fudhtagash banë,
gjakpirësh, ç' e fëllikjën ëmbrin t' ënë.
Për fakje t' bardhë t' ënde mot e monë
u mundova edhe prisha vetëhenë,
pa pritur kurr gjagjë nga ti ndëvonë.
Po ti më nxore, për shpagim, shëndenë,
se vrave djalin t' im, si vran t' ën' Zonë
ata çë më se ti fajtorë s' klenë.

---

3. Gluha ju thaft atij çë mirë thot
për tyj, o vënt i nëmur me t' vërtetë !
Nga gjindet i harruam edhe nga yn' Zot,
u shofshe edhe mos klofshe më në jetë !
Do t' ngrëhet dielli, po për tyj në kot,
e hënza s' do të t' gjenjë n' rrugë t' vetë . . .
Po t' mbetet ka, kujtim për tyj në mot,

---

që të . . .

fushtagash=bishash.

banë=banesë, fjalë e ré për poetin.

mot e monë=gjithmonë.

gjagjë=ndonji send.

t' ën zonë=përsëritje e idesë së pjesës së Irë, vargu 47-48.

ata çë se ti=ata që mâ tepër se ti . . .

v. 508-522. **Tingllim i lltë** : I u-thaftë goja atij që flet mirë për ty, o vend i namun me të vërtetë, i harruem nga njerzit edhe nga Zoti, u-shofsh edhe mos qofsh mâ në botë ! Dielli do të ngrihet por jo për ty, e hanza nuk do të të gjejë në rrugë të vet, por do të mbetet, për të të kujtue ty në kohë, vorri i t' im biri në mes të fletëve të dafinës. Dita mâ e mirë për ty do të jetë si nata e tmerrshme e të tjerëve, natë që then drita e rrufëve, deri sa tue u grimë në brengë të gjatë pa u-bashkue e pa u-përzitë me njerëz të mirë, prej dënimit do të kalbesh në mëkatë.

çë mirë thot=që flet mirë.

varri i t' im biri ndëpër lari fletë.
Për tyj po ka të jet më e mira ditë
si një e tmeroshme për të tjerë natë,
ç' e rrëfevet po then e liga dritë;
ngjera çë tuke u grir, në brëngë t' glatë,
pa të mirësh bashkim e pa përzitë,
do t' kalbesh, prej dëmnimit, në mëkatë.

4. Për ty po më vjen kekj edhe mëria
shkrihet në lotë e shuhet në rëkim
e zeza nëmë e bien fjalët e mia,
po si beronja çë ngë zën kjëllim;
se e të sjellt në e madhe u vjen fukjia
nga dhëmbëja e pasosme e e pa shërim,
e vëndit te ku u leva dashuria
hovin u pret atyre n' fluturim.

Po t' mbetet ka=e ardhëshmja e foljes me mbetë, do të mbetet.

në mot=në, gjatë kohës.

lari=laurum, dafina.

ka të jet=do të jetë.

dëmnim=dënim.

v. 522-536. **Tingllim i IV**të : Por, me gjith këtë, më vjen keq për ty edhe zembrimi shkrihet në lot e nama e zezë shuhet në rënkim, e fjalët e mija bien posi shigjeta që nuk e zen shenjin, sepse, në qoftë se fuqija e të sjellunit u vjen e madhe nga dhimbja e pambarim dhe e pashërueshme, dashunija e vendit ku leva u pret hovin atyneve në fluturim. (shigjetave). Si nji votër anmiqsh, ku të jetë shue zjarri, do të desha të të shifsha . . . Po a mund të nginjesha? Unë thom se do të më shtohesh brenga! Pse për të keqen t' eme, kundra dëshirës s'eme, due atë vend që do të desha të mos e due, e po e ndjej vehtea bir i atij që më theu kështu.

Po=Parafjalë që tregon ndryshimin e mendimit të poetit, i cili kalon nga nama në mëshirë.

beronja=shigjeta.

kjëllim=qëllim, shenji mbi të cilin shënojmë, qëllojmë; nishani.

të sjellët=emën foljuer i gjinisë asnj. të sjellunit, të goditunit.

Si vatrë armikjësh, te ku zjarri u shua,
deja të t' shihia . . . Po munt t' isha i ngir?
Brënga thom u se kish të m' shtonej mua!
Se, për të kekje t' ime, me pahir,
atë çë deja të mos deja e dua
e i kuj më theu kështu po ndihem bir.

III.

Nga çerdheja, ku gjarpëri i përpiu
të vocrin e 'saj, shkjyponja jik,
më krismë ç' i thek zëmbrën nga njeriu
çë s' ësht i lik.
Po shumë e ren për jetë atë të lërë,
se nuk e priste kurr të zezën herë
të të ndamit, e pran nuk vete e tërë
në vënde t' jerë.
Për mot e monë e lume ajo trashgoi

---

kish të m' shtonej=do të më shtohej.
i kuj=i atij që, it. cui, di cui.

III. Janë 12 strofa Safike.

v. 537-540. Shqiponja ikën nga çerdhja ku gjarpni i përpiu të vegjëlit, ikën me nji krismë që i prek zembrën çdo njeriu që nuk âsht i keq.

të vocërit=i vocër, të vocër; i vokër, të vokër (Dibër); të vegjëlit.
nga njeriu=ç' do njeriu.
jik=ik, ikën.

v. 541-544. Por ankohet, i vjen keq ta lajë atë për gjithmonë, pse kurr nuk e pritte çastin e lik që të ndahesh, e pastaj nuk shkon e tanë në vend tjetër.

e ren=e kemi pamë ma naltë, në pjesën e parë, në kuptimin e ankohem, këtu âsht pak ma e fortë; më vjen keq, vuej.
për jetë=për gjithmonë.
herë=çasti, ora.
pran=pastaj.

v. 545-548. Ajo gëzoi e lumtun për gjithmonë n' ata male ku i qeshi jeta, prej andej u-çduk mbi retë e vranëta, por u-kthye prapë,

ndër ata male te ku i kjeshi jeta;
andei mbi ret e vrërëta tymtoi;
po u pruar pameta,
të prëhej, për më t' gjerë fluturime,
më lart, edhe më lart te i rrimti kjell,
po si dëshiri i 'saj i pacaktime;
me syt në diell.
Me të dashur atje zëmbrën e zgjaj
e i mfortej krahu i lodhët me t' vërtetë;
zogun mësonte e me kujdes e mbaj
mbi shpinë t' vetë,
kur jashtë e sillte, lartësit të xënte,
me mot t' mirë e kur ushtonte gjëma;
po në të mbrazët ndo një herë e lënte,
sa t' ish, si e jëma,

---

për mot e monë=për gjithmonë.
trashgoi=shif pjesën e parë, vargu 50.
tymtoi=u-çduk si tymi.
u-pruar pameta=u kthye përsëri.

v. 549-552. . . . u kthye të pushojë për fluturime ma të hapta, ma naltë, gjithnjë ma naltë në qiellin e kaltërt të pakufij, sikurse âsht e naltë dëshira e saj, me sytë në diell.

të prëhej=që të prehej.

i rrimti=i kaltërt; këtë mbiemën, ndër arbresht, e kam gjetë vetëm ke Skiroi; poeti e përdor edhe ke vjersha: "Flamuri i Shkjipëris„, në njenin prej atyne gjashtë hymneve enthuziastë, që botoi me titullin "Këngat e Luftës„, me shënime e verejtje rreth çashtjes së Lindjes:

"Fluturo te i rrimti kjiell„.

i pacaktime=mbiemën i fjalës qiell ose dëshirë: qielli i pa kufij; ose dëshira e saj e pa caktueme.

v. 553-556. Atje shfrente zembrën me dashuni e me të vërtetë i forcohej krahu i lodhun; e mësonte zogun, e me kujdes e mbante mbi shpinën e saj.

të dashur=emën i gjinis asnj., dashuni.

sgjaj=kohë e pakryeme, shfrente.

mfortej=forcohej.

v. 557-560. . . . kur e sillte jashtë që të kapte naltësitë, kur ishte koha e mirë e kur ushtonte bumbullima; por nga nji herë

pa frikë e zëmbërmath e guzimtar,
në t' vështira i përvesëm e n' rrëzik;
kurr para botës të mos kish të shar
nga i huaj armik.
E i vogli rritej si m' e donte shpresa
e 'saj, çë heret tek ai më njihte
vehten, edh' erësh po m' i shtonej besa
të zot t' e shihte.
Prej vërash, ku më t' strukur i mban drita,
e ruajën kukavacat me zili,

---

e linte në vende të zbrasta të qiellit që të bahesh si e ama.

të mbrazët=me mbrazë (Dibër); me zbrazë; vend i zbrazët në qiell, pa air.

sa=parafjalë që tregon qëllim; e kam pamë vetëm në dialektin e Pjanës.

v. 561-564. (e msonte të bahesh) . . . trim e guximtar, t'ishte i mësuem në të vështira që të mos shahesh kurr para botës nga anmiku i huej.

i përvesëm=neolog. e poetit nga për e ves-i.

v. 565-568. I vogli rritej ashtu si ja donte shpresa asaj, sa shpejt njofti ajo n' atë vehten, e po i shtohej besimi ta shifte zot të ernave, të hypun mbi retë.

më njihte vehten=përsëritje e vargut 164, pjesa e parë.

erësh=t' ernave.

shtonej=e pa kryeme, shtohej.

besa=besimi.

heret=shpejt.

v. 569-572. Kukuvajkat e shikojnë me zili prej brimave ku i mban të strukuna drita, të gëzueme e panë gjarpnin e zi në pritë.

prej vërash=prej brimave, birave.

e ruajën=e shikojshin.

te prita=në pritë, në pusi.

v. 573-576. . . . e nuk folën . . . ashtu të shkretë e të lame në gjak e gjet nji natë nana e mjerë çerdhen e dashun e mbeti pa frymë, e shpirti i u mpak.

i u pak=mundet të ketë kuptimin e i u paksue, si n' italisht: "le venne meno l' animo„, por në Dibër kemi foljen me u-mpakë,

e të gëzuame gjarpërin te prita
e pan të zi,
e s' folën dot . . . Ashtu nji mbrëma e gjeti,
të shkretë e mjera mëmë edhe në gjak
çerdhen e dashurë e pa frymë mbeti,
e shpirti i-u pak.
Me t' shpejt u dint e me mëndér u sgjua,
si nga nj' ëndërr' e kekje e krahët shkundi;
si e llavurrë u përplas e u ngashërua . . .
Heshtin gjithkundi !
Nani ajo jik e kekj i vjen t' e lërë
vëndin ku për lëvdin më parë un ndes
e ku i jet zëmbra . . . Po nuk vete e tërë
e ndien se vdes !

IV.

Për gjith monë i paharruar

---

me të ra të fikët e ndoshta ka këtë kuptim.

v. 577-580. Me të shpejtë u-tund e u-zgjue me mnerë si nga nji andërr e keqe e i shkundi fletët; si e marrë u-përplas e u-ngashërue . . . heshtje gjithkah !

u dint=u-shkund, u-tund; me u-dindë=me u-ngritë : dindu vendit ! d. m. th. ngreu (Dibër).

i (e) llavurë=i lehtë, i metë, i krisun, i marrë; "a je i llavur?„ (De Rada) "Fjamuri Arbrit„; Përrallëz e Tridicinit.

581-584. Tashti ajo ikën e i vjen keq të lâjë vendin ku mâ para u-ndes për lëvdatë e ku i mbetet zembra . . . Por nuk ikën e tanë e ndien se po vdes.

nani=tashti.

IV. Janë 30 strofa 4 vargjesh, 120 vargje 8 rrokës, me rimë të kryqëzueme.

v. 585-588. **ke t' kjëndrosh**=do të qëndrojsh; kemi folë mâ naltë për formimin e kohës s' ardhëshme në dialektin e Arbreshve.

v. 589-592. **i jaft**=i aftë, i zoti; "digne„.

të lertit=a=e; i lartë, të lertë.

të ndermëve=të nderuemve ua shtove nderin.

v. 593-596. Gjithnjë të parët t'onë qenë mprojtës e dëshmorë t' atdheut; kanë nji emën të tillë në mes të gjithë atyneve që kanë nam si mprojtës t' atdheut.

ke t' kjëndrosh, o biri i jim;
se dy jetë t' kishe rruar,
s' munt të dukeshe më trim!
Bir i jaft i s' vjetrës farë,
mbi të lertit lart u çove;
dolle i pari ndër të parë,
nder të ndermëvet u shtove.
Kurdoherë t' parët t' anë,
kush me mënt e kush me dorë,
për atdhe, ndër hie sa kanë,
klenë mpronjësë e dëshmorë.
Mirë e xun, në vënt të vjetër,
gjithë ata çë ndesh u ran,
edhe e njohën, në ktë t' jetër,
sa në t' pakjes punë i pan.
Shumë thellët rrënjët t' ona
hijën brënda n' gji të motit;
përse Gjyshat te Dodona
plekjësuan në pyll të Zotit.
N' ara gurësh të rrethuame,

---

ndër hie sa kanë=ndër ata që kanë nam, emën, zâ.

klenë=qenë.

v. 597-600. Të gjith ata që i sulmuen Shqiptarët në Shqipni e mësuen mirë, edhe e njoftën në tokën tjetër, se sa punë të paqës mbaruen ata.

xun=nxunë, mësuen, kuptuen.

në vënt të vjetër=âsht Shqipnia.

në ktë tjetër=nënkuptohet fjala vend që âsht Italia, atdheu i dytë i arbreshve.

v. 601-604. Me këtë strofë poeti fillon të këndojë, shkurt, epopenë e fisit shqiptar, e si kreshnik i fundit në kohë âsht Minoi.

Rranjët e fisit shqiptar janë shumë të vjetra, aqë sa stërgjyshnit t' onë qenë edhe në kohën e Zeusit.

te Dodona=në tempullin e Dodonës.

pylli i zotit=âsht pylli i Zeusit.

v. 605-608. Paladha u-ndenue shum prej Shqiptarëve me vende të rrethueme prej gurësh, ku sot duken gërmadhat, me tempuj

te ku duken sot gërmadha,
me hierore, edhe t' kujtuanme,
shum u nder nga ata Paladha.
E ajo zonjë e mëndjes s' prehtë,
çë kish trimat në kujdes,
herë e pashme e herë e fshehtë,
do në luftë e do n' shërbes,
u dha ndihmë e zot u dolli,
e kjë t' shpallej e vërteta,
gjithasajtëna i përsolli.
sa ra dritë e re te jeta.
Më të bukurën e farës,
nuse t' dashurë, Ahileu
sglodhi, atje ku nami s' ngarës
kot e fsheu ajo ç' e leu.

———=—

që përmenden ende.

ara gurësh=janë tempujt e parë të Greqisë="Temenos„.

hierore=tempull.

Paladha=Athinaja, e Mençmja.

v. 609–616. **herë e pashme . . .**=herë e dukshme, herë e mshefët; dijmë nga mitologjija se perënditë u-shfaqeshin njerzve herë me fëtyrën e vërtetë të tyne, herë me atë të të tjerëve, të rrejshme.

do në . . . do në . . .=qoftë në . . . qoftë në.

shërbes-i-shërbise=punë, vepër.

gjithasajtëna=gjithandej.

sa ra dritë e re te jeta=deri sa ra dritë e re në botë; ndoshta do të thotë poeti deri në kohën e Krishtënimit, deri në çdukjen e fesë pagane.

v. 617-620. Akili sgjodhi për nuse mâ të bukurën e fisit atje ku kot e mshefi nga tundimi i namit e ama.

e bukura e farës=âsht Deidamia, e bija e Lykomedit, mbretit të Skyros, ku Theti e kishte mshefë të birin që të mos merrte pjesë në luftën e Trojës.

sglodhi=sgjodhi; sgleth=unë sgjeth, unë këndoj.

nami s' ngarës=tundimi i namit; e ngara=me nga, me cytë, me ngacmue. "la tentation„.

kot e fsheu=Odhiseu ishte ngarkue që të zbulonte Akilin

Fati e ndrydhi, po kurorës
Pirri u lint, pa të ndrysht me atë,
hyll nga hylli, e s' 'tij nën dorës,
rrjedhë dy u bashkuan më një;
se e pellasgëvet një degë
me Shkjyptarët u përzie,
sa fituan të vjetrit Gegë
ëmbër t' jatër edhe hie.
Po s' i humbi dot të fisit
kurr kjiparet të hieruashme,

---

atje ku e kishte mshefë e ama; u-bâ pra si nji tregtar shëtitës, e në mes të plaçkave të tjera, kishte edhe nji palë armë të bukura; kur u-ndoth përpara Akilit, të veshun si vajzë, ky rrëmbeu ato armët e bukura në vend që të mirrte ndonjë plaçkë tjetër; me këtë të sgjedhun e njofti Odhiseu dhe e mori për në ekspeditën e Trojës.

v. 621—628. Fati e shtypi, por për kunorën leu Pirroja pa ndryshue nga Akili, leu si yll nga ylli, dy fise u-bashkuen në nji, nën urdhnin e tij, të Pirros, pse nji degë e Pellazgëve u-përzie me Shqiptarët, në mënyrë që të vjetrit gegë fituen emën e nam tjetër.

fati e ndrydhi=fati i caktuem për jetën e Akilit ishte : nji jetë të gjatë, por pa emën, pa zâ; nji jetë të shkurtun, por plot nam; mori pjesë në luftën e Trojës, fitoi emën, prandaj vdiq i ri, prandaj e ndrydhi, e shtypi fati.

pa t' ndrysht me atë=pa ndryshue nga Akili.

s' tijë nën dorës=e nën dorën e tij, nën sqeptrin e tij, nën urdhnin e tij.

rrjedhë dy=dy rrjedhje, dy fise.

Duhet pohue se këtu poeti humbet në mitologji sa nuk mirret vesht me kjartësi se ç' do të thotë; cilët janë këta dy fise që u-bashkuen në nji ? Mos vallë fisi i Akilit me atë të Lykomedit t' ishullit të Skyros ? Mos vallë poeti qysh atëherë don ta quejë shqiptar fisin e Pirros ? Atëhere del ky spjegim : fisi i Akilit, Shqiptarët, u përzitën me fisin e Lykomedit, Pellazgët; por fjala "të vjetrit gegë„ ç' kërkon këtu kur flitet për fisin e Pirros, për Epirotët ?

v. 629-636 Por dera e jonë e papushtueshme, me gjith që

edhe ndënji n' majë t' lisit
dera e jonë e papushtuashme.
Këtei dejtit, ndër Tirrenë,
nuk kle e dytë, e atei, në dhatë
kle t' paris mbi t' rit Përthenë
ku u bashkua me Bu e me Spatë.
N' krahë t' bushme pëndë t' reja
vu shkjyponja e u ngreh në kjell,
e shëndriti si rrëfeja
e ndër mjegulla si diell.
Ushton zëri i t' rreptit mbret
çë, si i zoti i pyllit t' lasht,
të kuj ëmbër kishte mjet,
shtrëngimtarët kjiti jasht;
e lartohet burri i dheut,

---

u-përzijt me Pellazgët, nuk i humbi kurr tiparet e perëndishme të fisit; këndej detit Adriatik, në mes të popujve të detit Tirren, dera e jonë nuk qe e dytë, e andej detit qe në shkallë të të parëve ndër Parthenët e ríj, ku u-bashkue me dy fiset Bu e Shpatë.

kjiparet=greqizëm,=tiparet.

të hieruashme=të shejta, të perëndishme.

ndër Tirrenë=poeti që shkruen âsht n' Itali; nji pjesë e Shqiptarëve të vjetër kaloi detin Adriatik dhe zu vend në krahinën e Italis "Etruria„, pra Etruskët e vjetër.

në dhatë=në gradë, në shkallë.

Parthenë=janë Bardhenët, në mes të Elbasanit e të detit.

v. 637-640. Shqiponja vu pupla të reja mbi krahët e fuqishme.

t' bushme=i bushëm; i bëshëm=i fuqishëm.

pendë=pupla.

v. 641-648. Ushton zani i mbretit të rreptë, i cili si Zeusi në nji kohë i nxori jashtë shtypësit . . .

i t' rreptit mbret=âsht Skenderbeu, të cilin poeti e krahason me Zeusin.

mjet=tamam, mu.

shtrëngimtarët=shtypësit.

Gjini=Gjin Bue Shpata.

v. 649-656. Pse Gjini erdhi në Siqili e themeloi Pjanën në

Gjini, i zot i Çamëris,
shok i parë i Skanderbeut,
trim ndër trima t' shkjypëris.
Në Siçilie përse jerdhi
e të Merku Pjanën vu ?
Përse gjakun nuk e derdhi
e la vëndin, kur u zu ?
Përse dhunë s' deshi t' vuaj
nën armikut, e me t' jerë
bashk u nis për dhe të huaj,
sa të priste t' bardhën herë.
Shënji i shpis nuk ka në kot
dy drangonjë m' krah kjyteze,
as pa arsye një hyll i plot,
n' arë t' kukje t' 'tij heth rreze !

Merk ? Pse s' e derdhi gjakun por e lâ Shqipnin kur u-pushtue ? E lâ, pse nuk deshi të pësojë turp nën armikun e me të tjerë u-nis për dhe të huej për të pritë atje orën e bardhë.

te Merku=vendi ku âsht themelue Pjana dei greci.

kur u zu=kur u-pushtue.

dhunë=turp, poshtnim.

sa të=që të.

v. 657–660. Shenja e shtëpisë nuk ka kot dy drangoj në anët njij kështjelli, e nji yll i plotë nuk lëshon rreze pa arsye mbi sipërfaqen e kuqe të saj (të shenjës). Poeti na flet për stemën e familjes së Skironjëvet; kjo na bân të themi bashkë me poetin se familja e Skironjëvet zbret prej familjes së vjetër shqiptare të Bue Shpatajve.

E Minushi âsht stërnipi i vërtetë i asaj familje. Në qoftë se këtu poeti nuk e thekson mirë këtë gjâ, vargu i parë i pjesës së VII. " O Mino, o rrjedhë luftarësh mbretëra „ na siguron krejtësisht mbi ç' ka thamë mâ naltë.

kjyteze=âsht gjindore=të njij kështjellës.

n' arë t' kukje=në sipërfaqen e pëlhurës së kuqe.

t' tij=shënja e shtëpis.

v. 661–664. Gjaku i mirë nuk bâhet ujë, gjaku që buron prej njerzve të mirë, sepse medje bâhet edhe mâ i pastër me kohën që kalon.

S' bëhet ujë gjaku i mirë
çë nga t' mirët po buron,
se më i thjesht e më i dëlirë
bënet mu, për mot çë shkon.
Kush se ti më i math, o djalë,
o i shkjyponjës s' lume zok ?
Lëvdin t' ënde me një fjalë
munt t' e thom : Nuk pate shok !
Të përbajtëmit përrua,
çë t' Tringjyemit ju lëshua,
mballë i rrijte, si drangua,
po ti vetëm, o Skjirua !
E n' at flamur i pështjellë,
të lëvdoshmin shpirt tue dhënë,
gjete ti t' pasosme gjellë,
si për trimat po kle thënë.
Le t' e klanjë i mjeri i jat
atë djalë t' shkurtash ditë,
çë do t' njihet i pafat,
se nuk dolli kurr n' dritë !

---

i thjeshtë=i pa përzijtun me gjâ tjetër, i pastër.

mu=bile, medje.

v. 665-668. **Kush âsht** mâ i math se ti, o djalë, o zok i shqipes së lume ? lëvdatën t' ande mund ta thom me një fjalë : Nuk pate shok !

Kush se ti . . .=nënkuptohet nji folje.

v. 669-676. Përruës së përbaltun, që i u-lëshue të tringjyrshit, vetëm ti, o Skiro, i ndejte përballë si nji drangue ! e i mbështjellun n' ate, tue dhanë shpirtin të lavduem, ti gjete jetën e amshueshme' ashtu si qe thanë për trima.

të përbaltunit=nga për e baltë, të fëlliqunit.

Tringjyeshmit=tringjyrsit, "tricolore„.

mballë=në=më, në ballë, më ballë, mballë, në ballë, përpara.

i rrijte=i ndejte.

gjellë=jetë.

si=ashtu si.

v. 677-684. I mjeri at le ta qajë djalin ditë-shkurtun, që do të njifet i pafat, pse nuk duel kurr në dritë ! Bashkë me të jatin

Le t' e klanjë bashk e jëma,
se të klari ka të drejt ! . . . .
Për tyj, bir, nuk duhet gjëma,
se për nder nuk vdikje shpejt !
Për tyj kënga, çë për burra
nga të dhestat zëmbra del
edhe shkon si e Drinit gurra,
çë për megje kurr nuk ngel.
Vala shkon e nj' atrë e re
ndjek atë çë n' dejt lëshonet;
Drinit hovi pran s' u pre,
as munt kurr t' i pakësonet.
S' i kjillon atij si tymit,
çë më shtillet e më men,
se po t' vjeft ep udha rrymit,

---

le ta qajë edhe e ama atë djalë, pse ka të drejtë ta qajë, kurse për ty, o bir, nuk duhet britma, se nga nderi qi fitove nuk vdiqe shpejt.

se nuk dolli . . .=pse nuk e tregoi vehten, nuk fitoi ndonji emën.

të klari=të qami.

gjëma=britma, të qamit.

v. 685.-688. Për, ty, o bir, kanga që këndohet për trima, del nga zembrat e ndesme, dhe kalon si burimi i Drinit, që nuk mbetet kurr nëpër ndalesa.

të dhestat=të ndestat, nga folja me dhezë.

megje-a=kufi; me qenë që kufini të ndalon të shkojsh prej nji vendi në nji tjetër, këtu fjala ka kuptimin e ndalesës, pengesës.

nuk ngel=me ngelë, me mbetë, ndalue, pengue.

v. 689-696. Kalon dallga e nji tjetër dallgë e ré shkon mbas asaj që lëshohet në det; kështu hovi i Drinit nuk u-pré kurr as kurr nuk mund të paksohet. Hovit të Drinit nuk i ngjan si i ngjan tymit, i cili sa mâ tepër mbështillet, aqë mâ tepër mënon, paksohet, pse rruga i jep fuqi rrymës nga të gjithë ujnat që gjen.

nj' atrë=një tjetër.

dejt-i=deti.

pran=konsek. prandaj, kështu.

S' i kjillon=nuk i ndoth, nuk i ngjan Drinit, me fjalë të tjera,

për gjithë ujërat çë gjen.
Ashtu nami i jyt, o bir,
ka me u shtuar pa kurr u prer,
ngjer çë t' nderet kush me hir
jetën dha t' atdheut për nder.
Ngjer çë dielli rreze t' kjesnjë,
ngjer çë bota edhe të jet,
ëmbri Mino s' mund të vdesnjë . . .
Kush t' e kjeknjë „u lumt!" do t' thet!

---

kanga që do t' i këndohet Minushit, s' i përgjet tymit; d. m. th. kanga e Minushit do të qëndrojë gjithnjë.

sa më shtillet . . .=sa mâ tepër të mbështillet, të bâjë rrathë, aq mâ tepër mënohet, paksohet.

t' vjeft=fuqi, forcë.

v. 697-704. Ashtu, si rryma e Drinit, do të shtohet edhe emni i yt, o bir, pa u premë kurr, deri sa të nderohet ai që dha jetën me qeif për nder t' atdheut.

ngjer çë t' nderet=deri sa do të nderohet.

me hir=me qeif, me gëzim.

Deri kur dielli do të lëshojë rreze, deri kur do të jetë bota, emni yt nuk mund të vdesi . . . kush ta përmendi do të thotë: I lumtë.

t' kjesnjë=me kjitë, qitë, nxjerrë, lëshue.

kjeknjë=me çekë, me përmendë, me zanë në gojë.

u lumt=u-ja âsht gabim, duhet i.

V. Përmblidhet prej 18 distikëve elegjakë.

Në këtë copë të bukur përshkrimesh madhështore. poeti na paraqet vehten të mjerë e të këputun përpara njerzve që qajnë fatin e tij të keq e që e ngushllojnë për kobin e math që e ka mbulue. Ky mjerim, kjo fatkeqsi, e bân krenar poetin, si do ta shofim mâ të theksueme në vende të tjera.

v. 705–712. I vetëm nëpër rrugë, me shpirtin të zanun prej kujtimeve, unë shkoj nëpër gjinde, e cila më vëren plot me dhimsuni; por s' âsht për të thanë se sa të randon mëshira e të tjerëve, sepse ajo të shkruen madhnin e të keqes, qoftë se këtë madhni të keqje e këthen në disa pamje të reja e të ndryshme

V.

I vetëm për në rrugë, me shpirtin kujtimesh të zënë,
u shkonj ndër gjinde, ç' e dhimpsurë më ruan.
Po e botës mëshërira sa rehet nuk ë për të thënë,
përse të t' kekjes të madhët ajo shkruan;
do se e nkëthen në t' reja, të ndryshme fytyrë disa,
ashtu si hënzën gjith' ujërat nga dheu,
e do se gjëmëmadhi të shumës i duket se ta
më posht se t' jerë çë fati i zi s' kurseu.
Një plak dardhan i kputur, i t' cilit sukull ë shtati
e jeta mundë e për të ren një barrë,
si t'pikjet rri te dielli, më sheh e m'lipisën : I ngrati!...
Bindë të rronjë, tue pasur atë varrë ! . . . .
Dhe rrozga, si tërhikjet tue lypur të shpivet në derë,
në bisht t' lahutës për currubij mizorë,
e thekurë më falet, po para s' më vjen si një herë,
se lik i duket sa të më ndenjë dorë.

---

ashtu si e këthejnë hanzën gjithë ujnat prej dheut, e qoftë se fatkeqi i math i duket shumicës se ta mâ poshtë se të tjerët që s' i ka kursye fati i zi.

për në=nëpër.
të zënë=të kapun, të kaplluem.
sa rehet—sa vuen, sa keq i vjen.
më ruan=më vëren.
nuk ë=nuk âsht.
të madhët=âsht kundrinë e drejtë e foljes **shkruan, madhninë.**
shkruan=ta bân, ta dëften aqë të gjallë si me ta pasë shkruejtë.
do se=qoftë se.
nkëthen=kthen.
gjëmëmadhi—ai të cilin e ka gjetë gjama, e zeza.
të shumës=turmës, rrëmetit; "a la foule„.

v. 713-720. Nji plak i këputun, të cilit trupi i âsht bâmë sukull e jeta i âsht bâmë nji mundim, e nji barrë për të renë, kur rrin të piqet në diell më shef e i vjen keq : — I ngrati, thotë, âsht për t' u çuditë se si rron me atë plagë ! Edhe plaka e këputun, ndërsa po hiqet rrëshqanas, tue lypë nëpër dyert e shtëpivet, të cilën e trazojnë rrugaçët e këqij, më përshëndet e prekun në zemër, por s' më del përpara, si më vinte njëherë, sepse edhe asaj i vjen keq që të më ndejë dorën.

O mjeri burrë i mjeri ! Thote nj'ëmëzë, e djalin ç'i rritet
në gjit si mollë, fort e shtrëngon tue fshar,
me t'dashuri një dridhmë, si i nokrri prej thithit i shkjitet
e jet i ndyshëm ndër gas e ndër të klar.
Nj' i vogëlith i varfër, çë zëmbrën i ngiste t' im biri,

---

dardhan=katundar.

sukull=âsht sukull, leckë, paçavure.

mundë=mundim, barrë e randë, vështirsi.

për të ren=për nusen e djalit.

si t' pikjet rri=kur, ndërsa rri të ngrofet në diell.

m' lipisën=greqizëm, lip, lipisi; **kam, dëftoj lipisi**=më vjen keq; "për mue i vjen kekj e lipisi m' diftojën„ (Mili e Hajdhia).

bindë=bindje, çudi, çudë, habi.

rrozga=plakë e këputun.

si . . .=kur, ndërsa.

në bisht t' lahutës=d. m. th. se rrugaçët e kanë objekt të kangëve të tyne, të talljeve të tyne.

currubij=currubin-i-j=rrugaç, "gamin„.

e thekurë=e djegun, e prekun në zemër.

më falet=më përshëndetën; arbresht e Pjanës, kur ndahen dy vetë, në shenjë përshëndetje, tue shtrëngue dorën thonë : "faljem„.

i duket lik=i vjen keq, s' i vjen mirë të më dali para tashti, mue që më ka ngjamun gjith këjo zi e madhe.

sa të më=që të më.

v. 721-728. I mjeri burrë, thotë një nanë, e tue fshamë e shtërngon në gji si mollë djalin që i rritet, me nji dridhmë dashunije, ndërsa i vogli i këputet prej themthit e mbetet në dyshim në mes të të qeshunit e të të qamit. Nji i vogël i vorfën që po i prekte zemrën t' im biri, i gërrisun e i rrjepun, me fyiyrë të verdhë si baltë, që kishte ndihma e përgëdhelje bërtet : — Sa i mirë ishte i' ati ! . . . — E prej dashunisë i dridhen lotët ke sytë.

me t' dashuri një dridhmë=me një të dridhun dashunie.

i nokrri=i nokërr, i vokërr (Dibër), i vocër=i vogël.

prej thithit=prej themthit, maja e sisës; kah thith bebja qumështin e nanës, prandaj thith-i.

shkjitet=shkëputet, këputet, nduket.

i shkjerrë e i rjepur, me fakjezën si bota,
e ndihmë i kish e dhelka: I jati! bërtet. Ç'ish i miri . . .
Edhe prej mallit te syt i dridhet lota.
E ti, moj vajz' e hieshme, m' e bukura skjirë e vullajës,
si trundafile, kur dielli perëndon,
e mbledhurë në vehte dhe e rënë të kallit prej majës,
me zëmbërë të thyeme, të dashurin kujton.
Po trimi i t' parës dorë, çë t' vjetëvet lulen e parë,
n' agim të ditës, me hir atdheut i fali,
i rrallë sot, ndër shumë, nga dhuna e shtrëngimit, ushtarë,

---

i ndyshëm=prej në e dy; i ndërdyshëm, "incertain„.

i ngiste=me nga, me prekë.

si bota=si balta; bot-a në disa vise âsht nji baltë e murrët që përdorin gratë për të lamë kokën; i thonë edhe : humë-a.

dhelka=përgëdhelje.

i dridhet lota=shprehje shumë e bukur, loti që dridhet, që lëvis pô sa del prej synit mbi mollzën e faqes.

v. 729-736. E ti . . . stolia mâ e bukur e kopshtit, e mbëledhun në vehte dhe e livarun mbi majën e degës, me zembër të thyeme kujton të dashunin.

Por kreshniku i kohëve të kalueme, që i fali atdheut me dashje në lulen e parë të vjetve në agim të ditës, e që âsht i rrallë sot në mes të shumicës që u-bânë ushtarë nga e keqja e shtërngesës, ky kreshnik betohet se nuk len mbas sodit ndonji mâ i fortë se im bir.

skjirë=stoli.

vullajë=votrat e kopshtit, këtu kopshti.

e rënë=e lëshueme, e livarrun.

të kallit=nuk âsht kallini, por dega që mban trëndafilin.

i t' parës dorë=ka kuptim kohje, jo radhe.

lulen e parë=rinin, të rijtë.

me hir=me qeif.

s' lehet=nuk lind.

v. 737-740. Kush pra do të vuejë si unë ? Po kush do të ngrihet mbi mue ? (antithezë shumë e bukur); jam me të vërtetë fatkeq, aq sa mund të jetë nji njeri; seicili të më qajë me të drejtë, por të drejtën e nderit e due vetë, pse kushdo nuk mund të ketë nji bir si Minon. (Nji strofë madhështore që të bân të

bën be se s' lehet ndo një më i fortë se djali.
Kush pran si vet do t'dhëmbët? Po kush do t'ngrehet mbi mua?
Vërteta i mjerë, sa një njeri munt t' jet.
Gjithkush të m'kle me t'drejte!... Po t'drejtën e nderit e dua
se bir si Minon kushdo nuk munt t' e ket ! . . .

VI.

Ujur përanë meje, tue xënë si amshonet njeriu,
syzit e 'tij të ndritëmit
ngulur te t' mit i mbante, me t' dashur, me nder e me bindë,
kurr pa më rrahur cinura;
sa më dukej bimë, ç' e gjelbërë, e njomë, e delloshme,
ngrehet e re te dielli,
jetëje prej burimit fukji tue marrë për dita
të ndahet midis t' jerave,
plot e plot në stinë tue kjitur të bukura lule
shumë edhe pemë t' ëmbëla.

---

qajsh bashkë me poetin përpara madhnisë së shpirtit të tij; ka plot të drejtë të krenohet).

pran=pra.
do t' dhëmbet=do të ketë dhimbje, do të vuej.
kush do t' ngrehet=kuj do t' i rritet emni mâ tepër ?
gjithkush=seicili.
të m' kle=prej : kla, të më qajë.

VI. v. 741–750. I ulun afër meje, tue mësue se si bâhet i amshueshëm njeriu, sytë e tij të ndriçuem i mbante të ngulun në të mijt me dashuni, me nderim, me habitje, pa me më rahë kurrë qepalla; kështu që më dukej nji bimë e cila e gjelbër, e njomë, e fuqishme ngrihet e re kah dielli, tue marrë për ditë fuqi jete prej burimit për t' u dallue midis të tjerëve tue lëshue në stinën e vet shumë lule të bukura e pemë t' ambla.

Ujur=i ulun, tue qenë i ulun.
tue xënë=tue nxanë, tue mësue.
amshonet=amshohet; "éterniser„.
me t' dashur=emën i gjinisë asnjanëse, me dashuni.
me nder=me nderim, respekt.
me bindë=me çudi.
cinura=greqizëm, qepalla.
sa=kështu që.

Tha me trishtim një herë:—Nuk lodhem, o tate, të t'gjegjem...
lum në kish' t' isha hieja !
Unë po ndiej se tretem . . . I sbet erdh' e e nisa, te zëmbra
me dridhmë edhe t' panjohurë :
— Fakje të bardhë patshe, për fjalën e mirë çë më thua,
djalëthi i jim i dashuri !
Ti, me uratën t' ime, do t' vësh të nderoshme një vatrë,
kjë të përtrihet ëmbëri,
nami edhe t' përtrihet për jetë i të parëvet t' anë,
me bij' edhe me nipëra,

---

e delloshme=neologj. e poetit nga fjala dell=e fuqishme, e fortë.

jetëje=abl. jete.

të ndahet=me qëllim që të dallohet.

tue kjitur=tue qitun, tue lëshue.

v. 751-762. Tha . . . : — Nuk lodhem të të ndigjoj . . . I lumi unë po t' isha vetëm hieja t' ande ! Unë po ndiej se po çdukem . . . Fillova . , . me të dridhun të panjoftun : — Ti . . . do të themelojsh nji votër të ndershme që të përtrihet emni, e që të përtrihet edhe nami i të parëve t' onë me djem e me nipa si degë e atij druni . . . që nuk u trembet ernave.

të t' gjegjem=e kemi pamë edhe mâ naltë, të të ndigjoj.

në kish t' isha=po të ishnja.

tretem=humbas, shdukem.

Kodrat e Llazit=një vend në P. dei Gr.

do t' vësh=do të vêsh, do të ngrefish, kurdisish, themelojsh.

nuk i trembet erëvet=i-ja âsht gabim duhet u.

v. 763-778. Zogjt, me zembër të qetë mblidhen tufa-tufa nën degët të atij (druni) dhe bâjnë çerdhet. Mbi atë, në mbramjet e ngrofta i vetëm, pa gjumë, bilbili i këndon hanzës : . . . Por e zeza koha e jona nuk âsht për andrra dashunije e për kangë . . . Bota ndryshon ! E sheh . . . ? Jeta âsht nji lëvizje pa ndalim . . . Kush punon âsht shtypë nga ata që vijnë të fundit. Por nuk âsht e udhës shpejtimi, Në rrugë të gjatë e të vështirë nuk lodhet i mençuni, e mâ tepër pse s' ka kufi të ecunit t' onë gjatë kohës për tatin e mirë të burravet. Jeta s' mbaron . . . ! Përsosmënija do t' ishte vdekje.

nën 'tij=nën atë.

degë t' atij druri, ç' i vjetër te kodrat e Llazit,
kurr nuk i trëmbët erëvet.
Mlidhen nën 'tij ndër gjethe plim plim e çerdhezit bëjën
zogjët me zëmbrë t' kjetëme.
Mbi 'të, te t' vaktat mbrëma të verës, i vetëm pa gjumë,
këndon bylbyli hënëzës . . .
Po koha e jonë e zeza malli për ënderr' e këngë
nuk është . . . Ndërronet shekulli !
E sheh si krejt të gjitha po marrin fytyrë të reja ?
Jeta pa u ndalë t' luajur.
Përpara! e po përpara!... Kush prëhet ë shkelur e shtypur
nga ata çë janë t' sprasëmit.
Po s' është me ligjë vrapi. Në rrugë të glat' e t' vështir
nuk lodhet dot i mentëshmi;
dhe më se s' ka t' arrënë të jecurit t' anë te moti,

---

plim plim=tufa-tufa.

koha e jonë e zeza=ndërto : e zeza koha e jonë nuk âsht për ënderr' malli . . .

shekulli=ka kuptimin : bota :

Jeta pa u ndalë t' luajtur=jeta (nënkuptohet folja âsht) âsht lëvizje pa ndalim.

t' sprasëmit=të mbrapmit, të fundit.

me ligjë=me të drejtë, e udhës.

dhe më se=edhe mâ tepër pse.

t' arrënë=emën i gjinisë asnj., arritje, mbritje.

të jecurit=t' ecunit.

Unjia=përsosmënija; në pjesën e parë të poemthit, vargu 476, poeti, në vend të kësaj fjale përdor "t' kryem„.

v. 779–792. Rron . . . kush shkon përpara pa kputë edhe e njef shenjën si të pambritshme. Ata që njifen si prijsa do të mbeten në majat e nalta e mâ të ashpra të maleve, u hedhin dritë turmave të fushës e u mbajnë të gjallë besimin; ata ngulin nëpër majat e vendeve të veçantë për të tjerë fenerë që s' shuhen. Kështu për jetë do të shkëlqejnë Kaukazi, Deifi, Kapitoli e Kalvari i amshueshëm. Nga ata tempuj të Zotit, me flamuj të hapët, të lumtunit (prijsat) nisen e rishtas shkojnë përpara tue tërhekë turmat, përpara , . . mbas dritës së shejtë.

kush vete=kush shkon përpara.

për fat të mirë t' burravet.
Isht e pasosme jeta. Përpara ! Përpara ! Përpara !
Unjia do t' ishte vdekëje.
Rron e jeton gjith monë kush vete gjith monë edhe shënjin
e njeh si të paprekëshim.
Në t' lartat kanë t' ngelur malesh më t' ashpëra majë
ata çë njihen prinjësit
e tubëvet të fushës e dritën u hedhin e besën
mbajën të gjallë atyreve.
Ngulin ata për t' jerë, në vlugje t' veçorëshmish vënde,
fenerë të pafikshëmë.
Për jetë ashtu shkëlzejën Kafkasi, dhe Delfi e Kaptoli
edhe Kalvani i amshuashëm.
Nga ato hierore t' Zotit, me flamur të shtjellë, të lumët
nisen e shkojën rishtaze

---

të paprekëshim=që nuk preket, kapet, arrihet.
kanë t' ngelur=do të ngelin, do të mbeten, do të rrijnë.
e tubëvet=të turmavet të njerzve.
besën=besimin.
vlugje-gu-gje=maja.
t' veçorëshmish=të veçantë, të caktuem për një qëllim.
shkëlzejën=do të shkëlqejnë.
Kafkasi , . .=Poeti numuron katër tempuj, katër vende nderimi të njerëzimit. Kafkasi âsht nji tempull, pse atje u-vra nga rrufeja Prometheu, ai që, edhe tue dijtë ndëshkimin, sakrifikoi vehten për të ndriçue njerëzimin, për t' i falë zjarrin, mjetin e parë të përparimit të njerzimit mbarë. Prometheu ra nën të goditunit të rrufesë së Zeusit vetëm për të mirën e njerëzimit; edhe Minushi qé nji idealist i tillë. Delfi ishte vend adhurimi i Grekëve të vjetër, në Kapitol ishin tempujt e ndryshëm të perëndive romanë, dhe Kalvani, Kalvari vend i shejtë i gjithë Kërshtënizmit.
nierore=tempuj.
të shtjellë=me shtjellue, me përhapë, të hapët.
godhët=turmat.
v. 793–802. Përpara . . . me kohë ndryshojnë të gjitha, por vdekja âsht nji rrenë. Naltë zembrën e ballin pse shpërblimi, për ate që e ndien, âsht vetë të qenunit. Vetëdije e plotë âsht jeta; nji veshje që ndryshon âsht shtati, që ne e lâmë për nji

edhe tërhekjin godhët. Përpara ! Përpara ! Përpara !
Pas dritës të hieruashme !
Përpara ! O burra t' lodhëtë, ndryshonen të gjitha me motin;
por është e rreme vdekëja.
Me zëmbrë n' lart e ballë ! se shpagë, për vetin ç'e ndien,
të klënët isht në vetëhe.
Vetdije e plot' ë jeta; nj' e veshtë e ndërroshëme shtati,
çë lëm për më t' çëmoshëme.
Gjë nuk ka më t' mirë se t' pasurit klënë mbi dheun,
e t' klënit si nj' e dukurë;
si e dukurë e t' pasosmit, si një nga fytyrët e 'tija;
po e mirë, e lartë, e hieshme.
Lum tri herë i drejti ! Tri herë i lum edhe trimi
çë, për të drejtë t' gjithëve,
jetën e tij tue dhënë, me gjurmë shënjon çë ngë shlyhet

---

veshje mâ të çmueshme. Nuk ka gjâ mâ të mirë se të kesh qenë mbi dhé si nji dukje e të qenmes; si nji dukje e atij që nuk mbaron, si njena prej fytyrave të tij, por fytyrë e mirë, fisnike, e bukur.

e rreme=âsht gjinija femnore e mbiemnit (i rremë, e rreme, të rremë) që përdoret si emën.

shpagë=shpërblim.

për vetin ç' e ndien=për atë që e kupton; vetin=“la personne„.

të klënët isht në vetëhe=ndërto : për vetin ç' e ndien, shpagë isht të klënët në vetëhe=Për atë që e kupton, shpërblimi âsht të qenët vetë. (l' existence elle-même).

ë=âsht.

e veshtë=veshje, robe.

e ndërroshme=që ndrohet.

t' çëmoshme=të çmueshme.

t' pasurit klënë=të keshë qenë.

e t' klënit=e të qenunit, qenjes; “de l' être„.

nj' e dukurë=nji dukje, nji pamje, nji shfaqje; “une manifestation„.

e t' pasosmit=që nuk soset, nuk mbaron; “de l' infini„.

v. 803-810. Tri herë i lumtun âsht i drejti, tri herë i lumtun âsht edhe trimi, i cili, tue dhanë jetën për të drejtën e të gjithëve,

shtegun e t' mirës gjindevet;
sa m' i kjëndron i ndershëm, ndë gjigje e rrenime kjytetesh,
ëmbër te jeta e jetëvet !
Po lum e lum mbi t' lumit ai çë, pa u lidhur të bëmës,
krethet te dejti i pakjëjes !
Heshta e kështu bërtiti : — Për botën e tërë te zëmbra
kam dashuri dhe vllezërë
njerëzit njoh, o tate, çë rrin te katr' anët e dheut,
si t' dalë prej një prëhëri,
do çëdo ngjyrë patshin; do çëdo farëje klofshin,
se kanë gjak edh' eshtëra,
si gjithë i kemi e shpirtin, rrjedhim të një shkaku t'njënjishëm;
çë s' ka të zënë e sosëje,
Por si, pas vëndit, bimët, ashtu edhe njerëzit janë
në tubë të përzierë.

---

me gjurmë që nuk shlyhen u shënon rrugën e të mirës njerzve, në mënyrë që emni i tij qëndron i ndershëm për jetë ndër gërmadhat e rrenimet e qyteteve ! Por i lumtun mbi të gjithë ai që, pa i u-ngjitë landës, zhytet në detin e paqës.

shtek-gu=vendi i hapët për të kalue në nji garth, këtu : rrugë e hapët.

t' mirës=e të mirës, e të mbarës, e të drejtës.

ndër gjigje=ndër copa të thyeme, dërmla.

të bëmës=landës.

krethet=m' u kredhë, m' u zhytë.

te dejti=në det.

v. 811-818. Heshta . . . . : — Dashuni të madhe kam në zembër për tanë botën, edhe njerzit i njof si vëllazën, o babë, që rrijnë në katër anët e dheut, si të dalun prej nji prehëni, çdo ngjyrë paçin, çdo fare qofshin, mbassi kanë gjak, eshtna e shpirt si kemi ne të gjithë, rrjedhje të njij shkaku të njëjtë që s' ka fillim as mbarim.

do çëdo=çfarëdo, çdo.

farëje=ablatif, fare.

rrjedhim=rrjedhje; "émanation„.

të zënë e sosje=fillim e mbarim.

v. 819-828. Por sikurse janë bimët të përzieme si mbas vendit, kështu janë të përziem në grupe edhe njerëzit; ujnat,

Ujërat, era e hajet, çë toka dhuron edhe dielli
pjek vënde vënde të ndryshëme,
të ndryshëmë edhe bëjën ndër 'ta njerëzorët bashkime,
sa njëri krejt nga jetëri
ndahet për kjipare ç' i japin vetí të veçantë
për kurm, për mënt, për ndienja,
dhe ja varin shpirtin më tokën e dashtë ku lindi,
te ku do t' gjenjë prëhëje.
Pran katundin t' ënë mbi t' gjithë e të bukurën atme
i dua, si zogu çerdhezën.

---

ernat e hajet që dhuron toka e që dielli i pjek të ndryshme vende-vende, të ndryshme i bâjnë në mes të tyne shoqënitë njerzore, sa dallohet krejt njena nga tjetra prej tipareve që i japin vetina të veçanta, në trup, në mendje, në ndjenja dhe ja përulin, ja drejtojnë shpirtin, kah toka e dashtun ku leu, atje ku do të gjejë prehje.

tubë=tufa, grumbuj.

hajet=hejet, ushqimet.

njerëzorët=neologj. e poetit.

njeri . . . jetëri=njeni . . . tjetri.

ndahet=dallohet.

kjipare=tiparet, shenjat dalluese.

ja varin=ja livarin, ja përulin, ja drejtojnë.

v. 829–840. Pastaj mbi të gjithë due katundin t' onë e atdheun e bukur, ashtu si e don zogu çerdhen. Pasuni le të kërkojnë të tjerët, tue rrahë botën anë e mb' anë. Për ata ku âsht mirë. âsht atdheu. Po ku vallë jemi mâ mirë se atje ku pamë mâ para dritën e bardhë dhe diellin? Ku do të ndodhemi mâ mirë se atje ku kemi shtëpinë, ku jemi të njoftun e ku vendësit i njohim si të njij fisi? Po ku do të jemi mâ mirë se atje ku na flasin edhe gurët e ku na ndihemi me qejf të zanun e të lidhun me leqet e dashunisë, leqe që janë të pakëputshëm?

Kjozmë=pasuni.

te nj' anë e te nj' etër=në nji anë e në tjetrën; në këtë vark me foljen rahur nënkuptohet fjala botën, pse thuhet me rahë botën.

. . . ku mirë, isht atmeja=poeti përkthen fjalën e vjetër latine: "Ubi bene, ibi patria„; kemi dy fjali, në të parën nën-

Kjozmë kërkofshin t'jerë, tue rrahur te nj' anë e te nj' etrë!...
— Për 'ta, ku mirë, isht atmeja.
Po ku, po ku më mirë se atje ku dritën e bardhë
dhe pam më para diellin ?
Se atje ku kemi shpizën; ku jemi të njohtë e ku njohim
si të nji fisi vëndësit ?
Po ku, po ku më mirë se atje ku na flasin edhe gurët
e ku, me hir na ndihemi
të lidhurë e të zënë nga t' ëndëshmit lekje të mallit,
çë janë të pathyeshmë ?
Ky mall te zëmbra e jime ësht rrënjë edhe e mallit për atmen,
rrënjë e fukjishmë e e thellëtë;
si i mallit ky për t' jerë bij' ëmash të vëndeve t' jerë,
kur rrin përtej sinorevet,
çë kurr pa faj nuk çahen . . . Armik kush për dhunë te shpia

---

kuptohet folja isht: ku mirë isht, isht atmeja; ku âsht mirë, ku ndodhet mirë njeriu, atje âsht për të, atje ka atdheun e tij.

me hir=me qejf, me gjithë zemër.

lekje të mallit=lak, leqe të dashunisë. Nji lak, shumë leqe. Në Dibër ka kuptimin e njollës, qi asht turqiz., por edhe atë të lakut.

v. 841-852. Kjo dashuni në zembrën t' ime âsht rranjë edhe e dashunisë për atdhe, rranjë e fuqishme e e thellë; kjo dashuni âsht si ajo qi kam për të tjerët bij nanash të vendeve të tjerë që rrijnë përtej kufive, kufij që nuk kapërcehen kurr pa faj . . . E kam anmik atë që don të më hyjë në shtëpi për të më turpnue, e âsht i të huejit dhe i shituni i tij kushdo që guxon në mes t' onë të shajë flamurin e atdheut. Për ty, o shenjë e bukur lirije të plotë, o shenjë bashkimi e vllaznimi të përgjithshëm, unë u-bâfsha flî dhe derdhësha të tanë gjakun për të shpëtue prapë gjinden !

kur rrin=kur rrijnë përtej kufijve pa na prekun kufijt e atdheut t' onë, po të rrijnë.

sinorevet=përdoret edhe gjetiu, kufijvet.

nuk çahen=nuk kalohen, nuk kapërcehen.

armik kush . . =nënkuptohet folja.

njënjije=njijsie, bashkimi, rasa gjindore. "Unité„.

t' gjithëshme=të përgjithshme. "Universel„.

n' u-duht=në u dashtë.

do të më hinjë, e i t' huajit
ë mik e atij i shitur kushdo çë guzon në mest neve
t' atmes të shanjë flamurin . . .
Për tyj, o shënj i bukur lirije të plotë e njënjije
e vllazërije t' gjithëshme,
n' u duht, u bëfsha flijë, dhe derdhësha gjakun e tërë,
prap të shëndoshet gjindëja !

VII.

O Mino, o rrjedhë luftarësh mbretëra,
të rreptish trima shtërnip i ndritëshëm,
o e gjelbëra degë e nji lari,
çë pushtetin e jetëvet mundi,
isht e vërteta se çel të kjeshurit
kush për të t' jatit lëvdonet vepëra,
kur sillet për fakje të zezë
të shtëpis e të vëndit ku leu.

---

të shëndoshet=me qëllim që të shpëtojë; shpesh kemi hasë edhe në fjalën shëndet në kuptimin shpëtim, kuptim të cilin ka këtu edhe folja.

VII. Janë 16 strofa katërshe pa rimë.

v. 853-860. O Mino, o ti, që zbret prej mbretënsh luftëtarë, stërnip i ndershëm trimash të rreptë, o degë e gjelbër e nji dafine, që mundi fuqinë e shekujve, âsht e vërtetë se ngjall të qeshunit ai që lavdohet me veprat e t' et, ndërsa ai vetë sillet për faqe të zezë të shtëpisë e të vendit ku leu.

rrjedhë=rrjedhja e fisit; rranja, gjaku, fisi.
pushtetin=fuqinë.
e jetëve=të shekujve.
çel të kjeshurit=me çelë, me ndezë, me ngjallë të qeshunit.

v. 861-868. Por kush shkon mbas gjurmës që i lanë të parët, tue qenë në krye të pararojës në kohë të ndryshme, sa t' i shtohet nam prej fisit të vjetër, në dobi të atdheut të dashtun, ai me të drejtë të plotë le të përgëzohet për fisin që e nxori në këtë botë.

thep-i=maja, kryet.
ballnikut=nga ball-i rradhët e para.
t' vjeftur=shërbim, punë, dobi.
për rrënjën=rranjën, fisin; "origine„.

Po kush pas gjurmës, çë lanë t' thellët
të parët, vete, në kohë t' ndryshëme,
tue klënë t' ballknikut te thepi
e për ndienja e për punë të larta,
sa nam i shtonet prej 'tij së vjetërës
farë, me t' vjeftur t' atmes së dashurë,
ai me të drejtë të plotë
le t' gëzonet për rrënjën ç' e kjiti !
Ka mu dëtyrë, se i nget të njohurit
për 'ta ç' i dhanë fukjin e duhurë
të ndahej nga e shuma e pa ëmbër
e mbi t' jerët të çohej të moshës.
S' ka më me ligjë lëvdi ndër njerëzit
se ajo çë t' mirët i njeh të mirëshit,
te i nipi tue ndertur të gjyshin,

---

e kjiti=e nxori, e polli.

v. 869-876. Nji i tillë medjé e ka për detyrë këtë gjâ, mbassi duhet të jetë mirënjoftës kundrejt atyneve që i dhanë fuqinë e duhun, që të dallohet nga e shumta që s'ka emën për t' u ngritë përmbi të tjerët të kohës së tij; s' ka lëvdatë mâ të drejtë në mes të njerëzve se ajo që i njef të mirët të zbritun prej të mirëve, tue nderue në nipin të gjyshin, porsi nderohet druni në pemën e dëshirueme,

mu=bile, medje.

se i nget të njohurit=pse i përket, i ka hije, duhet të jetë mirënjoftës; poeti gjetkë thotë :

Po tue luftuar si trimavet i nget
Te varri ranë. (Te Dheu i Huaj — pjesa e parë).

d. m. th. si u ka hije trimavet, si u përket trimavet.

të njohurit=emën i gjin. asnjanëse, njoftje, mirënjoftje.

të ndahej=që të dallohej.

e pa ëmbër=që s' ka emën.

me ligjë=me të drejtë, e udhës, me vend.

të mirëshit=rrasa rrjedh , prej të mirësh.

kërkoshme=neologj., që kërkohet, dëshirohet; âsht italianizëm : "ricercato, rechérché„.

v. 877-884. Hija e shtëpisë, e familjes, nuk e svoglon hijen e nji njeriu vetë as nuk mund ta shuejë.

po si drurin te pema e kërkoshme.
Jo vehtjetoren e derës hieja
bën më të vogëlë, as munt t' e shuanjë;
si n' Shënjez' e njëshmeja sile
s' i prish vetín mosnjërit e hyjvet.
Ndonse t' nji lënde, ndonse t' nji prëhëri,
nga gjëja e gjallë të gruas të lindurit
ndryshojën për dritën e shpirtit,
çë të sglidhur' i mban te rrethaku.
Ashtu sicilli, pas ëndës s' vetshëme,
e ka të t' sjellit në dorë sgledhëjen.
E haptë e të kekjes ë rruga;
po me driza e me glëmba e të mirës.
Të prënderoshmit mbi shkrepet duallën
me mundë t' madhe; shumë tue vuajtur

Ndonse të njij lande, ndonse të njij prehëni ata që lejnë prej grues ndryshojnë nga kafshët, pse kanë dritën e shpirtit që i mban të zgjidhun, të lirë në rrethin e caktuem.

hieja e derës nuk e bën vehtjetoren më të vogëlë=hija, nderi i gjithë familjes nuk e pakson nderin e çdo njenit të familjes.

vehtjetoren=çdo njenin; "individuo„.

n' Shënjëz'=Yjt e Pleiadëve.

e njëshmeja sile=shkëlqimi i përbashkët, i përgjithshëm.

mosnjerit=asnjenit.

gjëja e gjallë=kafshët, por në kuptimin që e përdorim ne janë vetëm ato të shtëpisë si lopë, dhen e dhi, etj.

të sglidhur=të sgjidhun, të lirë.

te rrethaku=në rrethin.

v. 885-892. Kështu seicili, mbas dëshirës së vet, e ka në dorë të zgjedhunit të sjelljes së vet. Rruga e së ligës âsht e hapët, por ajo e së mirës âsht e zanun me driza e me gjemba. Të ndershmit me mundime të mëdhaja hypën përmbi shkrepat; të rrallët u shquejtën nga turma tue vuejtë shumë, dhe ngrefën, themeluen votrat fisnike.

secilli=seicili.

s' vetshëme=të vetën; "propre„.

të t' sjellit=të sjelljes.

nga grumbulli u shpikën të rrallët
edhe vatrat i ngrehën të larta.
Marre përtesa në brinjë t' bjeshkavet!
Krenare maja çohet mbi mjegullat;
po caku i vështirë përkitet
vriguj mishi te shtegu tue lënë.
"Më lart për herë, me syt te dielli!
kle fjala e jote, si u nise t' hypeshe,
o bir, çë mësova me t' bëmat;
biri i jim, çë me fjalën po ndeza.
Ashtu të t' rivet, ashtu të t' lashtëvet
më një vëlesat bashkë të përzieme
u dukën tek ti më një herë
e të lartat kjipare edhe zëmbra.
Tue derdhur gjakun në rrugë t' ashpërë,
e zure sprakën e ngule flamurin,
ç' i bukur valon në të kaltërt,
si shpëresëje e besëje e gazi
burrash, çë duhen si të mirë vllezërë,
burrash të lirë shënj i pavdekëshim,
nën hyllit të bardhë, çë s' bie
e çë rreze lëshon mbi gjith dheun.

---

sgledhëjen=zgjedhjen, të zgjedhunit; "le choix„.
ë=âsht.
të prënderoshmit=për e nderë neologj., të nderuemit, të ndershmit.
mundë-a=mundim.
u shpikën=u-dalluen, u-shquen.

v. 893-900. Asht gjâ e turpshme të përtuemit mbi brinjët e bjeshkëve! . . . por caku i vështirë përkitet tue lanë copa mishi nëpër rrugë. Fjala e jote: — . . . . o bir, që unë mësova me vepra . . .

Marre=nënkuptohet folja âsht.
caku=kufini, vendi i caktuem, qëllimi.
përkitet=me përkitë, me përka, me prekë.
vriguj=vrigull-i-j=copa.
si u nise=kur u nise.
me t' bëmat=me punë, me vepra.

v. 901-912. Kështu, në ty u-dukën me nji herë së bashku të

VIII.

Isht e këthehet e para verë;
zë bota e tërë të përtërihet;
te t' lartat majë bora më shkrihet;
bulë e barbukje
zën e shpërthejën një t' jatrë herë,
disa të bardha, disa të kukje;
të vaktës frymë, ç' i sgjon për jetë,
bimët po kjesin të parat fletë;
e si te pylli
po ngrehet kënga, po ndihet fylli,
vishen me t' gjelbër e kodra e mali;
vjen dallëndysheja ... Po s' më vjen djali! ...
Në të pasosëm të kaltërt kjiell

---

përzieme vetijat e të rijve e të të vjetërve, u-dukën edhe tiparet fisnike edhe zembra . . . e kape majën . . . që i bukur valon si shpresë, besim e gëzim . . . për burrat . . .

më një=së bashku, po n' at kohë.

vëlesat=vleftat, virtytet, vetitë.

sprakën=majën, naltësinën.

si shpëresëje e besëje e gazi=tri emna në rrasën gjind.

VIII. Asht nji kangë në strofa 12 vargjesh, në vargje 10 rrokjesh, vargu i 4tërt dhe i 9ti i çdo strofe âsht pesë rrokësh.

v. 912–924 Po kthen prandvera; e tanë toka zen të përtrihet; bora po shkrihet në majat e nalta; burbuqet po shpërthejnë përsëri . . . ; në ajrin e ngrofët, që i zgjon për të jetue, bimët po nxjerrin fletët e para; e, ndërsa po ngrihet kanga në pyll e ndërsa ndigjohet fylli, kodra e male po vishen në të gjelbër; vjen dallëndysha por s' më vjen djali.

Isht e këthehet=po kthen; këtë mënyrë të shprehuni e kanë të gjithë arbresht : isht e shërben=po punon.

bulë=gonxhe.

të vaktës=dhanore, në të voktin, të ngroftin air.

e si=e ndërsa, mbassi (kohore).

v. 925–936. Në qiellin e kaltërt të pafund hanza e ftofët gjithnjë e ndrydhme duket edhe dielli i math mveshet e xhvishet me rreze Ata lejnë rishtas si hyjt që perëndojnë e prapë sbu-

e ftohta hënzë po e ndryshme duket,
edhe me rreze ngjeshet e nduket
i madhi diell.
Ata, si hyjëzit çë përëndojën,
rishtaze lehen, prap shukurojën:
për sysh të pame fare të rreme,
vdesin e ngjallen në kohë të preme;
kur një po janë
dhe kurr në vehte ndërrim nuk kanë.
Po do të sgjonet në varr kush flë ? . . .
Djalin e dashur kam t' e shoh më ?
U thom vetvetit : S' duhet vajtim
as për kë vete, as për kë rri
edhe te jeta. Njeriun çë di,
vapë e tëtim,

---

kurojnë; për shikime krejt të gabueshme vdesin e ngjallen në kohë të caktueme, ndërsa janë të njëjtë dhe kurr nuk kanë ndryshim në vetvehte. Po a do të zgjohet vallë ai që fle në vorr ? a do ta shof mâ djalin e dashur ?

të pasosëm=pa fund. pa mbarim.

ngjeshet=mveshet; përdoret për armët p. sh. akcili e ngjeshi kollanin e fyshekëve për brezi.

nduket=me shkëputë, me shkulë; këtu âsht pak e fortë për të thanë xhvishet, lirohet, pastrohet.

për të pame sysh fare të rreme=nga të pamet, shikimet të gabueshme të syve.

të preme=të caktueme.

kur=ndërsa.

kam t' e shoh=a do ta shof ?

v. 937-948. Unë thom me vehte : — Nuk duhet qamë as ai që shkon as ai që rri ende në këtë botë. Njeriun e dijtun si vapa, si të ftoftit, si qejfi, si dhimbja e gjejnë të njëjtë; ata pa qëndrim në vetvehte, shkojnë ashtu si vijnë e s' e trondisin ndonjë herë atë që qëndron gjithmonë si shkambi i pandieshëm, qoftë se t' i lëmon vala rranjët me murmurim t' ambël, qoftë se ta rrahi me shkumbë plot rrëmbim.

për kë=për atë që; (thuhet në Dibër).

edhe te jeta=ende në botë.

ëndë e të dhëmbur e gjejën një;
se, pa të mbajtur në vetëhenë,
ashtu si vijën, ashtu edhe venë,
dhe s' turbullojën ndo herë atë,
çë jet si gumë,
gjithnjë i pandieshëm, do se gërsin,
me t' ëmbël murmur, vala i lëpin;
do se e rrëmbyeshme e rrah me shkumë.
S' muntet me klënë se ç' ë t' mos jet;
i rënshëm kurmi; po ai çë t' gjallët

---

tëtim=të ftoftit.
ëndë=andje, kandje, dëshirë, qeif.
një=njisoj, të njëjtë.
pa të mbajtur=pa qëndrim.
ndo herë=ndonji herë, kurr.
çë jet=që mbetet, që qëndron.
si gumë=si shkamb.
do se . . . do se=qoftë se . . . qoftë se.
gërsin=kallxore, rranjën.
e rrah=e rreh.

v. 949-960. Nuk mund të ngjajë që të mos jetë ajo që âsht; trupi bije, por ai që i jep giallni e trajtë landës e dritë në ball, nuk tretet si retë; i lirë e i zgjidhun nga bota e jonë, e cila nuk ka shqise që ta shofi, shkak e jo rrjedhje, ai do të qëndrojë i mbaruem në vetvehte për gjithmonë, sepse mbi atë të lumtun e humbi koha fuqinë brenjëse, që, ndalë nga ndalë i prish shëndetin atij të cilin e ka nën urdhën, si nji krymb që s' shihet.

ç' ë=ajo që âsht; "ce qui existe„.
i rënshëm=me ra; "caduque„.
t' gjallët=jetë, giallni.
s' tretet=me u-tretë, me u-humbë, me u-shdukë.
sa t' e vështronjë=që ta, për ta veshtrue.
rrjedhë=rrjedhje; "effet„.
i kryem=i mbaruem, i përsosun; poeti përdor edhe emnin abstr. të këtij mbiemni: t' kryem.
për mot e monë=për gjithmonë.
pushtetin=fuqinë.
brenjtar=neologj. me brêjtë, ngranë.

e trajtë ep lëndës e dritë n' ballët,
s' tretet si ret;
i lir e i sglidhur nga bota e jonë,
çë nuk ka shkjisë sa t' e vështronjë,
shkak e jo rrjedhë. do të kjëndronjë,
i kryem në vehte, për mot e monë;
përse pushtetin
sbori mbi t' lumin moti brenjtar,
çë dal' e dalë po grin shëndetin
kuj ka nën urdhër, krymp i papar.
Vetëm një i marrë munt të helmonet,
se humbi dielli; vetëm një i lënë,
se dolli rishtas, munt të gëzonet,
e bardha hënë.
Pran, si i kënakjur s' ësht për të ler,

---

kuj ka=të atij që ka; mënyrë ndërtimi ital.

v. 961-972. Vetëm . . . vetëm nji i lehtë nga mendja mund të gëzohet se hanza e bardhë duel përsëri. Kështu i dituni i vërtetë, sikurse nuk âsht i kënaqun për lemjen, nuk mbetet i këputun as për vdekjen. sepse, me thanë të vërtetën, jeta nuk ka mbarim, ashtu sikurse pat fillim: ashtu si i gënjen të dukunit, të thuesh, të shumtën e njerzve, pse ata nuk e verejnë, por që do të kishin shpirtin të qetë po ta dijshin jetën si frymë të zotit.

i lënë=i lehtë nga mendja.

për të ler=që ka lemë, për lindjen.

nuk jet i prer=nuk mbetet i këputun, nuk i vjen keq.

të sosur=mbarim, fund.

si t' zënë=fillim; "principio„. Jeta nuk ka mbarim, si pat fillim.

si duka rren=ashtu si i gënjen të dukunit. pamja.

vën ren=ve re, me vu re, re-ja, kallzore renë, këndej kemi foljen me verejtë.

në Zoti e dijën . . .=po ta dijshin jetën si frymë të Zotit; dijën, kushtore.

v. 973-984. Seicilli prej nesh merr nji personalitet të dallueshëm me punët që bân, e ky personalitet nuk ndryshon. Asht mâ mirë të jesh i pafat e i mjerë se të jesh nji që gëzon.

Për veprat e mira që ka bâmë ka shpërblim në jetën e

ashtu, për vdekëje, nuk jet i prer
i dishmi fare; përse, vërteta,
nuk ka të sosur si t' zënë jeta :
si duka rren
thuaj se të shumët, se s' i vën ren;
po çë do t' kishën shpirtin më vënt,
në Zoti e dijën frymë njëmënt.
Vetëje t' ndame nga njeri nesh
po merr me punë e ajo s' ndërron.
Pa fat e i mjerë më mirë të jesh,
se një ç' trashgon !
Të ndonjë s' mirëje, te jeta e parë,
përtei dëshirit, shpagime ka
kush ësht i poshtër; i miri kla
ndo faj më tepër, të gjenjë t' mbarë

---

parë, përtej çdo dëshire, ai që âsht i poshtër; i miri qan për ndonji faj që të gjejë të drejtën pa kufij, pse i madhi i drejtë nuk don të ketë detyrime kundrejt kurrkujt . . . Djaloshi luftën e fitoi shpejt, pra qëndro të bashkohesh me të (e mos kërko shpërblim këtu në këtë botë, pse do ta keshë në atë tjetrën).

vetëje t' ndamë=“personalité distincte„.

nga njeri nesh=seicilli prej nesh.

ç' trashëgon=që gëzon, që dëfren.

s' mirëje=gjindore, së mire.

ndo faj=ndonji faj.

të gjejë të mbarë=për të gjetë, që të gjejë të drejtën.

detyrë=borç, detyrim.

v. 985-996. Qëndro . . . ti nuk kërkove nji njeri të pavdekshëm, kur . . . . . që të kishe nji djalë për nder të vendit, ashtu si leu për fat të mirë, sepse në qoftë se ke dhimbje se qysh, se kur e se ku t' u pëlqye lutja e yte, mbi zemrën t' ande të vêsh nji gur, pa ngritun krye para fatit të pathyejshëm, e të tanë falja vehten Perëndisë si nji që vdes me vepra të këqija, e jo me vepra të mira kundrejt të gjithëve e kundrejt të tjerëve që ke në kujdes.

nuk bëre fjalë=nuk përmende, nuk vrave, “faire allusione„.

kur lype glat=prej gjatë, kur kërkove me të madhe.

pa cak, se s' do
të ket dëtyrë i madhi i Drejt . . . .
Djaloshi luftën e mundi shpejt;
me atë t' bashkonesh, ti pran kjëndro!
Kjëndro si burrë! . . . Nuk bëre fjalë
për të pavdekshëm, kur lype glat,
për nder të vëndit, të kishe djalë
si u le për fat.
Se pra në dhëmbe se kjysh e kur
e se ku t' lutur tyj t' u pëlkjye,
mbi zëmbrën t' ënde të vësh një gur,
para t' pathyeshmit pa ngrehur krye,
e Perëndis
u fal i tërë, si një çë vdes
vepravet t' kekje, jo mirësis
më gjithë e m' jerët çë ke n' kujdes.
Si luftë t' klënit e gjithnjeriu,
për nder të s' mirës, nga i miri u ndie.
Nuk rron kush ruhet nga dielli e shiu;
po rron kush bie,

---

të kishe=çë të kishe.

t' lutur=lutja.

v. 997-1008. Të qenunit, jeta e çdo njeriu mbahet, quhet prej të mirëve si nji luftë që zhvillohet për nder të së mirës. Nuk . . . por ai që bije theror . . . për bukurinë e andrrës së lumtun . . . kur bërtiti : le të vdesë . . . , le të më vrasin, por le të mbajnë zi për mue! Ti thue të ketë vdekë?

Zembra e yte të digjet; por je fajtor të ankohesh! Mos mallko, por në do që ta lavdojsh trimin ndizu me kangën zembrat fisit dhe miqve.

t' klënit e gjithnjeriu=të qenët, jeta e çdo njeriu.

u-ndie=u-mbajt, u-quejt, u-njoft.

klithi=bërtiti, këndej kemi edhe emnin klithmë-a, që përdoret mâ tepër.

vdeksha . . . më vrafshin=janë dy dëshirore për në vend të urdhënores, në qoftë se mund të kemi urdhënore në vetën e parë.

m' sjellshin zin=me sjellë zinë, me mbajtë zi.

si djali i bukur, për bukurin
e s' lumes ëndërrë, çë n' sy i shkëlkjeu,
kur klithi: vdeksha, po rroft Atdheu!
Kur tha: Më vrafshin, po m' sjellshin zin!
E thua se vdikj?...
Zëmbra të digjet; po faj t' ankosh!
Mos nëm, e trimin në do t' lëvdosh,
po ndis me këngën gjëri edhe mikj.
Kështu vetvetit, si i huaj, po flas;
mëndëja mbushet po s' kjetet dot
e mjera zëmbrë, çë fshan e thot:
O bir, o lule,
si i riu më para dhe i vjetri pas?
O trim, më nderte, po n' prush më ngule,
e s' munt rrëfyhet sa i math ky zjarr
t' jem vet i gjallë dhe ti në varr.
Ti n' varr?... Jo, bir!...
Kush vdes vërteta për 'të past hir!
Tyj te gjithë anët û ndienj e shoh,
e ashtu kush vëndit s' i ra në moh.

---

po faj t' ankosh=nënkuptohet nji folje (bân, ke, âsht etj).

mos nëm=me namë, me mallkue,; këndej kemi edhe emnin namë-a.

v. 1009–1020. Kështu i flas vehtes si i huej; bindem, por nuk qetsohet zembra... O bir, si (vdiq) i riu para të vjetrit?... më nderove... e nuk mund të rrëfehet se sa i math âsht ky zjarr që unë të jem gjallë dhe ti i vdekun... unë të ndiej e të shof gjithandej, e ashtu si unë të shof kushdo që nuk e ka mohue atdheun.

si i riu...=si bâhet kjo që, si âsht që etj.

sa i math ky zjarr=nënkuptohet folja âsht.

s' i ra në moh=nuk e mohoj.

Faqe	Rradha	Errata	Corrige
III	7	linne.	linee.
V	20	mbrendshm.	mbrendshëm.
VI	29	hoqidore.	hoqi dorë.
IX	30	La marscillaise.	La marseillaise.
IX	34	kuhtue.	kushtue.
IX	34	e seseicili.	e se seicili,
X	3	La marcillaise.	La marseillaise.
X	7	strelti.	stretti.
XV	13	në fjalëve.	të fjalëve.
XV	33	djeloshat.	djelmoshat.
3	4	të parë.	të parët.
13	5	t' meroshme.	t' tmeroshme.
19	4	e treti.	s' e treti.
36	9	shtrue.	shture.

BKSH

BKSH

BKSH

Çmimi : 4 lek

BKSH